

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7485 E diel 1 Prill 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

**Përplasja në tunelin e Kalimashit ka dy anë medaljeje. Njëra anë është politike. Cilido goftë shkaku i protestës: elementë të PD apo popullsi e thjeshtë, e vërteta ...**  
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA

**Një shikim përtej tunelit të Kalimashit**



Opinion i Ditës

**Deklarata përmbyllëse e 20 marsit 2018 e misionit të parë të monitorimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, pas dhënies së kreditës trevjeçare ...**  
Vijon në faqen 22

Nga BUJAR LESKAJ

**Për zbatimin pa kushte nga qeveria të rekomandimeve të FMN-së**



“Vandalët do të marrin ndëshkim”

## Rama: Dialog me kuksianët. Basha e Kryemadhi: Anulo taksën e rrugës

Kryeministri premtën dëgjesa me banorët. Këshilli bashkiak: Dhunën e ka nisur policia

Nga DARINA TANUSHI

Me një ton jo të qetë dhe emocion që i transmetohej gartazi, kryeministri Edi Rama i cilësoi “krime të rënda” zjarrin e djeshëm në Rrugën e Kombit si dhe goditjen e Policisë së Shtetit për të penguar dhunshëm ...

Në faqet 4-5

## KUKSIANET PERLESHEN ME POLICINE, DIGJEN E SHKATERROHEN VENDPAGESAT

# “BETEJE” NE RRUGEN E KOMBIT, 14 TE PLAGOSUR

Flakë në sportelet e Kalimashit, 3 orë tension e përplasje. Qytetarët: Të hiqet taksa 10 euro, policia na dhunoi. Xhafaj: Do të ndëshkojmë barbarët



(Në foto) Protestues duke u përplasur me policinë dhe djegur sportelet e pagesës së taksës në Rrugën e Kombit

Në faqet 2-3

FESTA E SULLTAN NOVRUZIT



**Kryekëshilltari i Erdoganit në Shqipëri: Turqia promovon paqen**

Në faqen 8

MILOSKO

Kush është peshkopi, mjeku dhe koleksionisti italian që solli portretin e heroit

## Koleksionistët që ruajtën imazhin e Skënderbeut

Në brendësi: “Modifikimi i Piramidës, a i qëndron kohës”, nga Ben Andoni

Nga BAJRAM PEÇI

Ka qenë koleksionisti i veprave të artit, një personalitet i shquar i Rilindjes italiane, Paolo Giova (1483–1552), i cili falë pasionit të tij, besohet se ka bërë të mundur të mbërrijë deri në ditët tona pamja



e heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Peshkop, mjek, fizikant, historian dhe biograf, ka hyrë në të famshmit si krijuesi i muzeut “Uomini illustri”, me koleksionin më unik që ishte parë me vepra arti në Europën Mesjetare ...

Suplement

DEMSPERBLIMI

**Çelet fondi për të përndjekurit, ja kush duhet të aktivizojë llogarinë**

Në faqen 7

ZGJEDHJET VENDORE

**Spaho dhe Vasili: Koalicion në 2019? Opsion i hapur, nuk përjashtohet**

Në faqen 6

LISTA E ATP

**Kompensimi, 1460 pronarët që marrin paratë, afatet për dokumentet**

Në faqen 9-11

KUJTESA E DEBATIT

**Kur aktorët i ankoheshin Nanos për Ramën: Projekt mafioz për teatrin**

Në faqen 12

## RRUGA E KOMBIT PROTESTA

"U shmangën skenarë kriminalë, askush nuk mundet të jetë mbi ligjin"

# Khafaj: Barbari, persona të rrezikshëm shfrytëzuan tubimin

"Sulm i dhunshëm ndaj policisë e pronës, do ndëshkohen"

Ina Allkanjari

Pas protestës për tak sën në Rrugën e Kombit, nëpërmjet një reagimi publik ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj u shpreh se persona të rrezikshëm të lartë shoqërore shfrytëzuan pabesisht të drejtën legjitime dhe paqësore të tubimit. Xhafaj foli për një skenar të rëndë kriminal, që ishte përgatitur dhe shënjestroi politikanë të caktuar si nxitës të djegies dhe shkatërrimit të sporteve në tunelin e Kalimashit. "Jam i keqardhur dhe u kërkoj qytetarëve, partive politike, medias dhe komunitetit të biznesit të distancohen ndaj gjithë atyre përfaqësuesve të partive politike, që kanë inkurajuar me një gjuhë nxitëse protestuesit për ushtri dhune ndaj policisë dhe shkatërrim të pronës, duke sjellë në vëmendje se ky është një precedent jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe antikushitetues", u shpreh ministri i Brendshëm.

### DEKLARATA


Më datën 31 mars, nga një përfaqësi e disa qytetarëve të Bashkisë Kukës u kërkuar që të zhvillohej një protestë në orën 11:00 për të shprehur kundërshtinë mbi tarifën që paguhet për automjetet që qarkullojnë në autostradën Milot-Morinë. Në përputhje me kërkesën e bërë dhe në respektim të kësaj të drejte themelore të qytetarëve, Policia e Shtetit krijoi të gjitha kushtet dhe mori masat e duhura sipas ligjit, për zhvillimin e këtij tubimi. Sikurse mundet të keni ndjekur nga njoftimi të ndryshme mediatike, manifestimi i presupozuar paqësor, u shndërrua menjëherë në një sulm barbar kundër punonjësve të Policisë së Shtetit dhe kundër pasurisë publike dhe asaj private. Grupe individësh të papërgjegjshëm, në përbërje të të cilëve në numër jo të vogël gjendeshin elementë me të shkuar të rëndë



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

### PROTESTUESIT

"Manifestimi i presupozuar paqësor, u shndërrua menjëherë në një sulm barbar kundër punonjësve të Policisë së Shtetit dhe kundër pasurisë publike dhe asaj private. Grupe individësh të papërgjegjshëm, në përbërje të të cilëve në numër jo të vogël gjendeshin elementë me të shkuar të rëndë kriminale, si dhe persona të tjerë me rrezikshmëri të lartë shoqërore", u shpreh Xhafaj.



Forca të policisë, dje gjatë protestës në Rrugën e Kombit

### TË PLAGOSURIT

Ministri i Brendshëm gjatë deklaratës theksoi se në protestë janë lënduar 12 punonjës të FNSH-së nga gurët dhe sendet e forta të hedhura nga protestuesit, ndërsa një punonjës policie është plagosur më rëndë dhe po merr ndihmën e nevojshme mjekësore në spital.

## "Shkaktarët do të vendosen para ligjit"

### Kryeprokurorja Arta Marku: Hetim të plotë, po punohet për të gjetur autorët



### MASAT

"Policia e Shtetit në zbatim të ligjit do të ketë një përgjigje të ashpër për çdo person që ka nxitur dhe është përfshirë në aktet e dhunës ndaj punonjësve të policisë dhe që kanë sjellë një dëm të madh ndaj pronës publike dhe private. Kush nxit dhunë dhe anarki do të marrë përgjigjen e merituar ligjorë! Askush nuk mundet të jetë mbi ligjin!", deklaroi Xhafaj.

për të gjetur autorët dhe shkaktarët e dhunës. Kryeprokurorja znj. Arta Marku mbështet dhe vë në dispozicion të Prokurorisë së Kukësit të gjitha burimet logjistike dhe njerëzore për zhvillimin me intensitet dhe rezultativ të hetimeve dhe

jtë të të lënduarve në protestë. Ndërkohë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës, drejtuesja e saj, Alketa Nushi me një grup prokurorësh të kësaj prokurorie shkuan në vendngjarje dhe po punojnë

vendosjen përpara përgjegjësisë penale të cilitdo që ka shkelur ligjin. Prokuroria është në komunikim të vazhdueshëm dhe në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, po kryen hetime për zbardhjen e ngjarjes", thuhet në njoftim.

mundet të justifikojë, në asnjë kohë dhe në asnjë rrethanë, sulmin kundër punonjësve të Policisë së Shtetit dhe shkatërrimin e pronës. Janë lënduar 12 punonjës të FNSH-së nga gurët dhe sendet e forta të hedhura nga këta individë, ndërsa një punonjës policie është plagosur më rëndë dhe

po merr ndihmën e nevojshme mjekësore në spital. Vlerësoj gjakftohësinë dhe profesionalizmin e treguar nga punonjësit e Policisë së Shtetit në situatën e ndodhur pak orë më parë, duke shmanjur kështu realizimin e skenarëve më të rëndë kriminalë, për të cilën ishin të interesuar provokatorët të cak-

kriminale, si dhe persona të tjerë me rrezikshmëri të lartë shoqërore, shfrytëzuan pabesisht të drejtën legjitime dhe paqësore të tubimit. Shpreh të gjithë mbështetjen dhe respektin për të gjithë ata qytetarë të një zone të dalluar për ndershëmëri, krenari dhe fisnikëri sikurse është zona e Kukësit, të cilët u dis-

tancuan nga këta individë të papërgjegjshëm, si dhe ndaj atyre që nxinin vëz zjarrin dhe dhunën për interesa politike dhe nuk u bënë pjesë e atyre, që pa asnjë shkak sulmuan egërsisht punonjësit e Policisë së Shtetit dhe shkatërruan pasurinë publike dhe atë private. Asnjë e drejtë e pretenduar nuk

tuar. Publikisht jap gjithë mbështetjen Policisë së Shtetit për çfarë ajo bën për të mbrojtur jetën dhe pronën e kujtdo. Jam i keqardhur dhe u kërkoj qytetarëve, partive politike, medias dhe komunitetit të biznesit të distancohen ndaj gjithë atyre përfaqësuesve të partive politike, që kanë inkurajuar me një gjuhë nxitëse protestuesit për ushtri dhune ndaj policisë dhe shkatërrim të pronës, duke sjellë në vëmendje se ky është një precedent jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe antikushitetues. Iu bëj apel autoriteteve të qeverisjes vendore në Kukës të distancohen nga këto akte të dhunshme dhe të ushtrojnë ndikimin e tyre, duke qenë bashkëpunues dhe në ndihmë të Policisë së Shtetit, për të mundësuar normalitetin për lëvizjen e lirë të qindra qytetarëve dhe transportin e mallrave sot dhe në ditët në vijim. Në cilësinë e ministrit të Brendshëm deklaroi se Policia e Shtetit në zbatim të ligjit do të ketë një përgjigje të ashpër për çdo person që ka nxitur dhe është përfshirë në aktet e dhunës ndaj punonjësve të policisë dhe që kanë sjellë një dëm të madh ndaj pronës publike dhe private. Kush nxit dhunë dhe anarki do të marrë përgjigjen e merituar ligjorë. Askush nuk mundet të jetë mbi ligjin.



**KUKES** - Këshilli Bashkiak i Kukësit, Hasit dhe Tropojës ka reaguar përmes një deklarate për protestën e organizuar në Rrugën e Kombit kundër taksës së vendosur në këtë aks rrugor. Sipas Këshillit Bashkiak, qytetarët janë thirrur në një protestë paqësore, por aktet e dhunës filluan nga forcat e FNSH para orës së fillimit të protestës. "Aktet e dhunës nisën nga ana e Forcave të Ndërhryjes së Shpejtë para orës së protestës. Ka qenë ndërhyrja e vazhdueshme e drejtuesve të protestës për të shmangur dhunën ndaj forcave të policisë. Aktet e dhunës nga protestuesit erdhën pas acarimit të situatës. Ne distancohemi nga çdo akt dhune ngado që të vijë". - thuhet në reagimin e Këshillit Bashkiak të Kukësit, Hasit e Tropojës. Gjithash-

**"Ne distancohemi nga çdo akt dhune"**

**Këshilli Bashkiak i Kukësit: Qytetarët janë thirrur për protestë paqësore, dhuna nisi nga FNSH**



**DEKLARATA**  
"Aktet e dhunës nisën nga ana e Forcave të Ndërhryjes së Shpejtë para orës së protestës. Ka qenë ndërhyrja e vazhdueshme e drejtuesve të protestës për të shmangur dhunën ndaj forcave të policisë. Aktet e dhunës nga protestuesit erdhën pas acarimit të situatës. Ne distancohemi nga çdo akt dhune, ngado që të vijë", - thuhet në reagimin e Këshillit bashkiak.

tu, në deklaratë theksohej se këshilli u kërkoi qytetarëve të Kukësit, Hasit dhe Tropojës që të sillen në

mënyrë paqësore dhe qytetare edhe pas protestës, më tej falënderon policinë e Kukësit për sjelljen korrekte të saj

dhe i kërkoi që të shmangë në maksimum çdo veprim që mund të çojë në acarime të mëtejshme.

Qytetarët: Policia na dhunoi me shkopinj gome. Të hiqet taksa, kjo është një kërkesë jetike

Ina Allkanjari

# Dhunë dhe flakë, protestë kundër tarifës në Rrugën e Kombit

*14 persona të plagosur, mes tyre kreu i policisë së Kukësit*

Mijëra banorë nga veriu i Shqipërisë, kryesisht Kukësi, Tropoja dhe Hasi, por edhe shqiptarë nga Kosova janë mbledhur paraditen e djeshme në Rrugën e Kombit për të protestuar kundër taksës së vendosur në këtë aks rrugor. Protesta e cila pritej të ishte paqësore ka degraduar në përplasje mes qytetarëve dhe policisë. Banorë të shumtë kanë qëlluar me gurë mbi efektivat e policisë, ndërsa këta të fundit janë përgjigjur me shkopinj gome e dhunë. Qytetarët janë shprehur se protesta fillimisht ishte e qetë, por ka qenë policia ajo që e tensionoi situatën. Protesta nisi në orën 11:00, ndërsa zgjati deri rreth orës 14:00. Qytetarë të shumtë bllokuan qarkullimin në të dyja anët e Rrugës së Kombit për rreth 3 orë. Fillimisht protestuesit u përleshën me forcat e policisë, ndërsa më pas u vunë zjarrin sporteleve ku do të paguhej taksa. Në vendin e ngjarjes kanë shkuar edhe forca zjarrfikëse për shuarjen e flakëve, por protestuesit nuk i kanë lejuar të ndërhyjnë duke bllokuar kalimin. Ndërkohë, policia u tërhoq në një distancë të konsiderueshme. Gjatë protestës qytetarët deklaruan se do të qëndronin 24 orë në rrugë deri në një reagim dhe tërheqje nga qeveria për taksën, por pas negociatave me policinë, në orën 14:00 protestuesit u tërhoqën. Nga protesta kanë mbetur të plagosur disa qytetarë si dhe 12 punonjës të FNSH, një oficer i qarkullimit Adem Visha



Sportelet e djegur në Rrugën e Kombit

dhe drejtori i policisë së Kukësit, Perlat Vatoci. **PROTESTA**  
Rruga e Kombit në pjesën që përshkon qarkun e Lezhës nga Miloti deri në tunelin e Kalimashit, është bllokuar për disa orë si shkak i protestës së qytetarëve kundër vendosjes së taksës. Protesta nisi në orën 11:00 dhe zgjati deri rreth orës 14:00, me përleshje mes banorëve dhe forcave policore. Në protestë morën pjesë këshilltarët e Bashkisë e Kukësit nga të gjitha partitë politike, shoqata "Biznesi

për Biznesin", banorët e Kukësit dhe pushteti vendor. Për përplasjen në Rrugën e Kombit pati reagime nga të gjithë drejtuesit e shtetit. Për shkak të protestës, radha e automjeteve ka qenë kilometrike nga Repsi në drejtim të tunelit të Kalimashit. Zhbllkimi i rrugës është bërë i mundur rreth orës 14 e 30 minuta, pasi janë larguar protestuesit. Ndërkohë, tre persona dyshohet se kanë mbetur të plagosur nga përleshja si dhe 12 punonjës të FNSH, oficeri i qarkullimit Adem Visha

dhe drejtori i policisë së Kukësit, Perlat Vatoci. Mësohet se ambulanca mbërriti në vend për të dalë zot kësaj proteste. Këtu jemi mbledhur pa asnjë dallim politik. Policia na dhunoi me shkopinj gome. Të hiqet taksa, kjo është një kërkesë e drejtë dhe jetike", janë shprehur protestuesit. Ndërkohë, shqiptarë nga Kosova të pranishëm në protestë janë shprehur se taksa e vendosur i dëmton. "Jemi kundër kësaj takse, e cila na dëmton. Kërkojmë që të hiqet taksa. Ajo dëmton rëndë biznesin në Kosovë, por edhe lëvizjen e qyteta-

pohuan se nuk do largohen deri kur të anulohet taksa. "Nuk do të ikim nga këtu pa u hequr vendimi për të paguar taksën. Kemi marrë iniciativën për t'i dalë zot kësaj proteste. Këtu jemi mbledhur pa asnjë dallim politik. Policia na dhunoi me shkopinj gome. Të hiqet taksa, kjo është një kërkesë e drejtë dhe jetike", janë shprehur protestuesit. Ndërkohë, shqiptarë nga Kosova të pranishëm në protestë janë shprehur se taksa e vendosur i dëmton. "Jemi kundër kësaj takse, e cila na dëmton. Kërkojmë që të hiqet taksa. Ajo dëmton rëndë biznesin në Kosovë, por edhe lëvizjen e qyteta-

rëve të thjeshtë. Ne erdhëm paqësisht, por policia reagoi duke goditur qytetarët", u shprehën shqiptarët nga Kosova. Në orën 14:00 pas shumë negociatave me policinë, protestuesit kanë hapur rrugën duke u larguar, ndërsa ka vijuar normalisht qarkullimi. Pas precipitimit të situatës dhe përplashes me qytetarët në Rrugën e Kombit, policia është tërhequr, ndërsa ka identifikuar të gjithë personat dhe pritet ata që të arrestohen. Deri tani janë identifikuar nga policia mbi 40 protestues, të cilët do të akuzohen për goditje ndaj efektiveve të policisë dhe shkatërrim të pronës.

**TAKSA E RRUGËS SË KOMBIT**

- Klasa 1/ motorët - 2.5 euro
- Klasa 2/ veturat - 5 euro
- Klasa 3/ autobus & kamionçina - 11.2 euro
- Klasa 4/ kamion i mesëm - 16.2 euro
- Klasa 5/ kamion i rëndë - 22.5 euro

# PROTESTA REAGIMET



SALI BERISHA

Duke e cilësuar "llum-kazani" Edi Ramën, ish-kryeministri Sali Berisha i kujtoi se Rruga e Kombit i ka sjellë Shqipërisë mbi 300 milionë euro në vit të ardhura. Ai i bëri thirrje Ramës të lërë kërcënimet e tij "frymëndara e plot urrejtje, me kod penal e narkopolicë".



EDI PALOKA

"Populli është 'barbari'?! Ata që e vjedhin e dhunojnë dhe e poshtërojnë këtë popull janë të civilizuarit?! Sikur të gjithë shqiptarët të tregonin aq qytetari sa treguan kuksianët, kjo qeveri dhe ky kryeministër barbar nuk do të vazhdonin të talleshin me këtë popull", tha dje Paloka.

Opozita bashkë kundër qeverisë, PD-LSI: Policia të refuzojë urdhrat për dhunë

# Basha: Rama të pezullojë taksën e rrugës, hetim pazareve të tij

Kreu i PD: Qytetarët të mos gënjejn nga një manipulator

Opozita është bashkuar mbrëmë, duke i kërkuar kryeministrit Edi Rama të mos kërcënojë qytetarët dhe të heqë forcat policore që kishin rrethuar Kukësin. Pas protestës së djeshme të qytetarëve kuksianë, kryetari i PD-së, Lulzim Basha u takua në selinë e PD-së me kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi e aleatët e tjerë të PD-së, takim pas të cilit u arrit në një deklaratë të përbashkët. "Ne dënojmë me forcë kërcënimet e Edi Ramës dhe kanozjet e tij historike për raprezalje policore. Ne urojmë që ato janë trillim i gjendjes së tij të rënduar psikike, me të cilën ai u shfaq sot para shqiptarëve", u shpreh Basha në emër të opozitës. "Ne shprehim mbështetjen tonë pa asnjë kusht ndaj qytetarëve të Kukësit, të Kosovës dhe të të gjithë Shqipërisë, të cilët preken dhe ndëshkohen nga tarifa e padrejtë dhe korruptive për udhëtimin në Rrugën e Kombit. Ne dënojmë dhunën barbare kundër protestuesve dhe kërkojmë vënien para përgjegjësisë të çdokujt që ka ushtruar dhunë kundër tyre. Ne u bëjmë thirrje qytetarëve të shmangin provokimet e dhunshme, por ta kërkojnë të drejtën e tyre vendosmërisht me çdo mjet demokratik", deklaroi Basha. Kreu i PD-së u shpreh: "Edi Rama duhet ta kuptojë mirë se nuk është vonë, se zgjidhja e situatës arrihet me dialog dhe jo me kërcënimin e raprezaljeve dhe pagujnë një taksë të rëndë dhe mirëmbajtje Rrugën e Kombit pa asnjë tarifë shtesë. Që kur ka ardhur në pushtet, ai e ka trefishuar taksën e qarkullimit dhe ka mbledhur gati 800 milionë euro nga kjo taksë. Edi Rama duhet të japë llogari pse shpërdorohet dhe nuk përdoret ky fond për mirëmbajtjen e rrugëve, që është qëllimi i vetëm kushtetues dhe ligjor i vendosjes së qarkullimit", thuhet në reagimin e opozitës. Opozita i kërkon kryeministrit ndërprerjen e menjëhershme të pagesave që ai u jep çdo vit koncesionarëve të plehrave dhe shëndetësisë për punë të pabëra dhe kalimin e këtyre fondeve për zbutjen e varfërisë në zonën e Kukësit dhe zonat e tjera të varfra të vendit. Njëherësh, kreu i PD-së, Basha u bëri thirrje shqiptarëve "të mos gënjejn nga mashtrimet dhe përgjërimit e shtirura të një kryeministri manipulator dhe të paskrupull që i ka gënjer, varfëruar dhe zhytur në papunësi, drogë dhe në krim çdo ditë këto katër vjet, por të kërkojnë të drejtat e tyre dhe një qeverisje të mirë dhe të denjë".



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha me kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi e aleatët e tjerë të PD-së, dje në konferencën për shtyp

## FLAMUR NOKA

Deputeti i PD-së, Flamur Noka tha dje se, "gjendja në Kukës zgjidhet duke hequr tarifën grabitqare të Rrugës së Kombit dhe jo duke kërcënuar me më shumë policë dhe më shumë dhunë. Sot është koha të shfuqizohet menjëherë tarifa e Rrugës së Kombit, e cila duhet të paguhet nga fondi prej 200 milionë euro që u merren shqiptarëve çdo vit me taksën e qarkullimit", tha ai.

Dërgimi i forcave speciale është një provokim frikacak dhe i rrezikshëm i Edi Ramës".

**POLICIA**

Në deklaratën e opozitës, një vend të veçantë kishte edhe thirrja për policinë. "Forcat policore duhet të jenë në funksion të luftës kundër krimit të organizuar, trafikantëve të drogës dhe kapjes së qindra krimi-nelëve që kërkohen nga drejtësia shqiptare dhe ato të vendeve europiane. Në gjendjen e sundimit të plotë të krimit që ka sjellë Edi Rama në Shqipëri, policia duhet më shumë se kurrë të luftojë kriminelët dhe jo popullin", thuhet në deklaratë. "I bëjmë thirrje çdo punonjësi të policisë të refuzojë urdhrat për të ush-

truar dhunë ndaj banorëve të Kukësit dhe i paralajmërojmë se do vihen para përgjegjësisë personale për çdo akt të tillë. Ne i përsërisim Edi Ramës kërkesën e prerë të pezullojë menjëherë zbatimin e tarifës", u shpreh Basha. Sipas tij, "korrupsioni i Edi Ramës dhe grabitja për përfitime vetjake nuk janë ligj dhe të mira publike. Pazaret korruptive të Edi Ramës do të hetohen dhe dënohen. Edi Rama duhet të bëjë transparencë dhe të japë llogari para takspaguesve shqiptarë se ku shkojnë çdo vit 200 milionë euro që shqiptarët paguan për taksën e mirëmbajtjes së rrugëve. Do të mjaftonte një e dhjeta e kësaj takse për të

## THIRRJA

"Edi Rama duhet ta kuptojë mirë sa nuk është vonë se zgjidhja e situatës arrihet me dialog dhe jo me kërcënimin e raprezaljeve dhe armëve. Qytetarët nuk mund të detyrohen të pagujnë një taksë të rëndë".



## DEKLARATA

Më herët kreu i PD-së, Lulzim Basha u shpreh: "Kjo tarifë është një gjobë ndaj popullit. Edi Rama e vendosi tarifën me dhunë. Me dhunën e kartonëve në parlament, dhunën e policisë dhe dhunën e të gjithë shtetit. Edi Rama po grabit qytetarët për të mbushur xhepat e tij".



Kryetarja e LSI mbështet protestën në Kalimash

## Kryemadhi: Revolta e kuksianëve, shenjë e fundit të këtij regjimi

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi u shpreh dje në mbështetje të protestës së qytetarëve në tunelin e Kalimashit, por njëherësh ajo u shpreh kundër dhunës së ushtruar. "Sot (dje) qytetarët e Kukësit dëshmuar qartas se fatet e një kombi nuk mund të jenë kurrsesi pjesë e lojërave perversive të një kryeministri të papërgjegjshëm. Ata që kanë humbur besimin të drejtimit i qeverisë, tek ekonomia që po shkatërrohet sepse Edi Rama do të kënaqë orekset e oligarkëve, sot janë shumica dhe më të fortë se kurrë", u shpreh Kryemadhi, në një reagim të saj pas protestës. "Revolta e tyre në Kukës është shenjë e qartë e fillimit të fundit për një qeveri që ka humbur besimin dhe mbështetjen, që po rrenon çdo ditë familjet shqiptare dhe që ndoshta sot mund të kuptojë që revolta ka qenë dhe mbetet fundi i çdo regjimi që sundon me dorën e krimit dhe korrupsionit", tha Kryemadhi. "Unë dhe LSI sot jemi kundër së kësaj takse, sepse shqiptarët sot vetëm për taksën e shfrytëzimit të rrugëve paguan për karburant 120 milionë euro në vit vetëm për shfrytëzimin e rrugëve. Dhe vetëm taksa e Durës-Kukës që është akoma e papërfunduar sot kushton për mirëmbajtje 4 milionë euro", tha ajo.



PETRIT VASILI

Kreu i grupit të LSI-së tha dje se janë mbi 110 protestues të plagosur dhe nën akuzë. "Kryeministri dhe qeveria kërkon të kriminalizojë dhe jo ta dëgjojë dhe respektojë popullin, ndërkohë që mbi 100 protestues janë plagosur. Kryeministri që poshtëroi popullin me fjalë të neveritshme si 'diçka që nuk ngrihet' duhet të ketë turp", tha ai.



KLAJDA GJOSHJA

"Protesta dhe revolta në Rrugën e Kombit janë pasojë e sjelljes arrogante të kryeministrit dhe qeverisë. E kam thënë disa herë se sjellje të tilla mospërfillëse ndaj problemeve të qytetarëve automatikisht sjellin revoltë. I bëj thirrje qeverisë të mos provokojë dhe të mos luajë me qytetarët", tha dje Gjoshja.



ERJON BRAÇE

Kreu i Komisionit të Ekonomisë tha dje se, "dhuna në Kukës, thirrur, organizuar dhe gatuar nga Sali Berisha dhe Lulzim Basha ka lidhje vetëm me pushtetin dhe vendimet kur ishin zotër të tij". Sipas tij, kjo dhunë "duhet të bëjë të harrohet vjedhja marramendëse në atë rrugë, vjedhje për të cilën kuksianët heshtën dhe e pranuan".



Kryeministri: Dëgjesa me banorët brenda 60 ditëve, abone për zonën

# Protesta në Rrugën e Kombit, Rama: Vandalët do marrin ndëshkimin e duhur

## "Këshilltarët e PS që iu bashkuan dhunës ikin nga partia"

Darina Tanushi

**M**e një ton jo të qetë dhe emocion që i transmetohej gatazi, kryeministri Edi Rama i cilësoi "krime të rënda" zjarrit e djeshëm në Rrugën e Kombit si dhe goditjen e Policisë së Shtetit për të penguar dhunshëm zbatimin e ligjit në vendosjen e pagesës në këtë aks. Pas dy reagimesh që Rama kishte postuar në rrjetin social, me t'u kthyer nga Vlorë, kryeministri doli në një konferencë të posaçme për mediat dhe tha se do të ketë ndëshkim për këto krime, por nga ana tjetër ai njoftoi se do të komunikojë me banorët dhe do ta sqarojë këtë taksë brenda jo më shumë se 60 ditëve, ndërsa ditën e hënë do të presë me kërkesën e tij, kryebashkiakun e Kukësit. Në këtë dalje, Rama përjashtoi nga PS të gjithë ata këshilltarë socialistë të Kukësit që iu bashkuan dhunës. "Ju siguroj se këto krime do të ndëshkohen me të gjithë rëndësinë e forcës së ligjit. Kush e vuri atë zjarr, kush ushtroi vandalizëm mbi pronën publike dhe private dhe kush guxoi të ngrejë dorë mbi forcat e policisë, duke cenuar njëkohësisht rendin e sigurinë e shumë udhëtarëve, përmes bllokimit të dhunshëm të lëvizjes nga të dyja anët e kufirit nuk do kenë asnjë shans ti shpëtojë ndëshkimit të ligjit", deklaroi përre Rama. Ai pati edhe një përgjigje për ata që nxitën protestën. "Zjarrnxitësve të kanzanit politik të Tiranës, atyre që mjerisht nuk e udhëheqin, por e udhëpërmbysin çdo ditë opozitën shqiptare, duke e mbajtur atë peng nga frika e drejtësisë së re dhe duke e keqpërdorur përditë si një instrument kërcënimesh ndaj rrugës europiane të Shqipërisë iu them kaq: As populli i krejt Shqipërisë, as populli i vetë Kukësit nuk kanë asnjë



Kryeministri Edi Rama

### EMOCIONET

Duke shpjeguar dridhjen e zërit gjatë daljes së mbrëmshme, Rama tha: "Kam një lajm për ata që merren me frymëmarrjen time në komunikimin e sotëm, kam gjak shqiptari, jo llum kazani në vena. Zemrën e kam në vend, jo në zorrë. Mish e shpirt i kam në dispozicion të detyrës dhe të atyre që e duan këtë vend me gjithë mend e këtë popull me gjithë zemër!"

lidhje me këtë shtafje të ulët vandalizmi dhe po ashtu, asnjë lidhje nuk kanë me dëshpërimin tuaj agresiv. Dhe përgjigjen prej Kukësit dhe prej të gjithë Shqipërisë, gjuha e benzinës dhe çizmja e dëshpërimit që tërheqin zvarrë opozitën do ta marrin mu ashtu siç e meritojnë, qershorin e ardhshëm, pa diskutim edhe më shembullore sesa përgjigja e qartë që morën në Kukës dhe ofrtë në mbarë Shqipërinë", deklaroi Rama. Sa për kundërshtarin e tij, Lulzim Basha ai tha: "Skam ç'i them, aq s'di, aq bën". "Të tërë bashkë, mbledhur në ballin e kanzanit politik me votat e njerëzve të zakonshëm të këtij vendi, këta udhëpërmbysës të opozitës nuk dinë të bëjnë asgjë tjetër, përveç asaj që kanë bërë gjithnjë, të tallen me pakicën dhe me pakicën e pakicës, për të nxitur rrënuja e zjarrnëztes kur janë në opozitë dhe për të bërë rrupallë e hapur gropa në çdo fushë të jetës shqiptare sa herë janë në pushtet", nënvizoi më tej Rama. Sipas tij, "fati i politikës mizerabelë të përrallave dhe shkatërrimit me ben-

zinë në gojë e me çizme në dorë është i shkruar dhe mbetet vetëm ta lexojnë deri në fund. Kukësi nuk mund dhe nuk do të kthehet kurrë në mish për zjarrin që duan të ndezin kartat e djegur të politikës së Tiranës. Për shumicën qeverisëse të këtij vendi dhe për mua si kryeministër, vandalët që dhanë sot një shtafje të neveritshme antishtetit nuk janë Kukësi, nuk janë Tropoja, nuk janë Hasi, nuk janë Shqipëria", shtoi Rama duke theksuar më tej: "Me vandalët, ne do sillmi siç e meritojnë shkelësit e ligjit. Ndërsa me qytetarët që e kundërshtojnë pagesën, sepse e konsiderojnë atë të lartë, ne do sillmi siç na e do vizioni që kemi dhe detyra që mbajmë. Do të bashkëbisedojmë, do të dëgjojmë me vëmendje dhe do të shpjegojmë me durim të gjitha të vërtetat e shtrembëruara, apo të mohuara kretj prej gjenjesharëve dhe sharlatanëve të kanzanit politik dhe mediatic".

shpeshtë i asaj rruge dhe këto janë të shkruara në kontratë. Pasi njoftoi takimin me kreun e Bashkisë së Kukësit, me shpresën që sipas tij, "deri të hënë, ai do të jetë distancuar jo nga kundërshtia për pagesën, por nga dhuna kriminale", Rama tha: "Po ashtu, çdo këshilltar socialist i Bashkisë së Kukësit që ka ngritur dorë gorrazi, apo me vetëdije për thirrjen e pseudoprotestës së ngjizur me urdhër nga Tirana për realizimin e shtafjes së sotme të barbarisë së dhunshme e ka humbur po sot të drejtën të jetë pjesë e familjes sonë politike. Partisë Socialiste të Shqipërisë. Unë nuk jam i pagabueshëm dhe përpiqem të bëj gjithçka mundem, që më e mira të bëhet për këtë vend dhe për njerëzit e zakonshëm të këtij vendi, pa asnjë dallim", tha Rama duke pranuar një lloj përgjegjësie, që kjo çështje nuk ishte shpjeguar siç duhet. "Në asnjë vendim apo veprim timin nuk ka kurrë tradhti të qëllimshme ndaj interesave të tyre, nuk ka kurrë indiferencë ndaj situatave të tyre, ndaj halleve të tyre - u shpreh Rama. - Mund të ishte shumë më e lehtë për mua që të thosha, le të mos e vendosim pagesën e rrugës, punë e madhe, nuk kemi dhimbje koke, le të degradojmë më tutje dhe pastaj vrafshin veten kur të mos jem më unë në karrige. Madje mund të thosha, e dini si është puna? Kjo kontratë që e nisi Saliu dhe e bitësin ministrit e LSI-së është një thikë pas shpinës suaj, por ju më keni mua dhe do ta heqim pagesën për inat të Saliut dhe për inat të LSI-së, por - shtoi Rama - unë nuk jam as lala Gjoni, as maçoqa me çizme, që sa të jem unë, t'ju them 'hani, pini e këndon', 'ku rafshi, mos u vrafshi', siç ju thoshte lala kur ju futi nëpër piramidë, apo kur hapu tunelin e Kalimashit me këngë e me valle dhe na e larta arkën e shtetit si piramidë mbi kokë, ndërsa rrugën pa ura me këmbë".



## Meta: Keqardhje për të lënduarit, të evitohet dhuna, duhet dialog

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, shprehu dje shqetësimin për situatën e krijuar në Rrugën e Kombit. Në një reagim të shkurtër, kreu i shtetit shprehu gjithashtu edhe keqardhjen për personat e lënduar gjatë protestës së djeshme. "Presidenti bën thirrje për evitimin e dhunës, për vetëpërmbajtje dhe dialog e mirëkuptim, me qëllim normalizimin e situatës dhe kthimin e lëvizjes normale të automjeteve dhe qytetarëve në pritje", thuhej në reagimin e Presidentit Ilir Meta. Kreu i shtetit nuk është shprehur këto ditë që është diskutuar në lidhje me vendosjen së taksës së kalimit në Rrugën e Kombit. Reagime të shumta pati edhe në anën tjetër të kufirit. Vendosija e një taksë të tillë është diskutuar, por jo tarifa, e cila për banorët e zonës dhe ata që e përdorin këtë rrugë çdo ditë është e lartë. Pak ditë më parë, rreth 150 kamionë nga Shqipëria e Kosova protestuan, duke i paraprirë protestës së djeshme në tunelin e Kalimashit. Nuk dihet nëse do të ketë një tjetër reagim të kreut të shtetit, ndërkohë që dje nuk pati as reagim nga pala kosovare.

**SHPLLALJE**  
**(PËR SHITJEN E SENDIT TË PALLUAJTSHËM NË ANKAND)**  
ME DATE 13.04.2018 NGA ORA 8:00 - 16:00. PRANË KESAJ ZYRE FERMBARIMORE DO TË ZHVILLOHET ANKANDI PËR SHITJEN E APARTAMENTIT ME SIPERFAQE 80.25 M2, NR. PASURIE 46/205ND+1-36, ZK 8518, VOL 43 I VENDOSUR NE DURRES L. 13 PLAZH, NE PRONESI TE SHOQERISE SIAC SH.P.K. CIMMI FILLESTAR PER ÇELJEN E ANKANDIT TE I+II ESHTE 3.389.760 LEKE.  
Te interesurit te parqiten prane zyres perbarimore A.D.R, Perbarues Gjyqesor Dorian Zazani, ne adresen : Durres,I.nr 2, rr. A.Goga, ose te kontaktojne ne nr. tel: 0672586883

Kreu i PBDNJ-së, Vangjel Dule në një intervistë për emisionin "Kjo Javë" në "News 24" komenton marrëveshjen e re të detit mes Shqipërisë dhe Greqisë, marrëveshje nga e cila siç tha ai, përfitojnë të dyja shtetet. Dule u shpreh se duhet që mes Greqisë dhe Shqipërisë nuk duhet të diskutohet më e shkuara, por të shihet nga e ardhmja. Dule u shpreh se ka deklaruar se marrëveshja detare e vitit 2009 ishte e drejtë. "Unë mbaj distancë nga zhvillimet politike në Greqi, pavarësisht se kam shtetësi greke, jam hermetik ndaj zhvillimeve atje. S'kam koment për deklaratat e zonjës Bakojanis dhe të zotit Kotzias, ato janë çështje të tyre të brendshme", u shpreh Dule. Sa u përket negociatave aktuale mes dy shteteve,

**Kreu i PBDNJ-së komenton negociatat Greqi-Shqipëri për detin**

**Dule: Të çlirohemi nga e shkuara, marrëveshja e 2009-ës, më e drejtë**

**VIZITA E TSIPRAS**

"Nuk ka rëndësi se kur vjen Tsipras, por ka rëndësi të themi se një vizitë e një kryeministri grek vjen pas një periudhe të gjatë dhe kjo është diçka pozitive", vlerësoi dhe kreu i PBDNJ-së, Vangjel Dule. Ndërkaq kryeministri grek, sipas kryeministrit shqiptar Rama, pritet të vijë në verë.

teteve, Dule tha se "çdo gjë do ndjekë rrugën institucionale". Sa i përket transparencës së procesit, Dule u shpreh se "kreut të qeverisë i takon ta bëjë këtë ndaj kreut të opozitës dhe presi-

dentit". "Ne dëshirojmë që marrëdhëniet me Greqinë të jenë siç e përshkrova më herët. Marrëdhëniet janë të Shqipërisë nuk mund të jenë ekskluzivitet i një force politike. Zoti Rama kam përsh-

tipjen s'ia kishte idenë çfarë ishte e drejta ndërkombëtare e detit, e gjeti marrëveshjen 'pre' të lehtë që të krijonte opozitë të kundërshtonte opozitën për tradhti, por kjo arriti që kjo t'i shkaktojë edhe atij kosto", nënvizoi Dule. Në këtë proces, sipas Dules nuk ka fitues dhe humbës, fitojnë të dyja palët. "Duhet vullnet pozitiv mes dyja palëve. Nëse do të ishte implementuar marrëveshja e 2009-ës, që për mua mbetet e drejtë, ose sa më shpejt të vijë një marrëveshje si ajo e



Kreu i PBDNJ-së, Vangjel Dule

drejtë dhe e ndershme do hapë horizontet të reja si për njërin palë edhe për tjetrën. Që të dyja vendet të përdorin resurset në mënyrë të përbashkët. Duhet të çlirohemi, të shikojmë pak më gjerë. Nuk mund ta mbajmë vendin peng të gjyqimeve dhe të mbetemi peng të atyre që na

trashëgohe. Termi 12 milje nuk është falje, aty ku ka 12 milje, do ndahet 12 për njërin dhe 12 për tjetrin. Nuk mbahet peng opinioni me përralla të kësaj natyre. Kemi potenciale të jemi një vend i integruar. Të konceptojmë çështjet në mënyrë europiane", u shpreh Dule.

Kryetarët e grupeve parlamentare të të dyja partive opozitare: Aksion i përbashkët

**Koalicion në zgjedhjet vendore 2019? PD-LSI: Nuk e përjashtojmë, të hapur**

*Spaho: Do të koordinojmë veprimet në Kuvend*

Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim nuk përjashtojnë një koalicion të mundshëm mes tyre në zgjedhjet vendore të qershorit që vjen. E nëse një koalicion i tillë do të konstituohet, fitorja në shumicë do të ishte e vështirë për Partinë Socialiste. Pak ditë më parë, të grupet parlamentare patën një mbledhje të përbashkët, e cila kishte edhe si qëllim të përcjellë mesazhin se dy partitë opozitare tashmë janë të bashkuara në një qëllim të vetëm. Largimin e kryeministrit Edi Rama. Dy kryetarët e grupeve parlamentare PD e LSI theksojnë se është herët për të folur rreth kësaj çështjeje, pra bashkimit në një koalicion për zgjedhjet vendore, edhe pse si Edmond Spaho, ashtu edhe Petrit Vasili nuk e përjashtojnë mundësinë e daljes në një koalicion në garën për 61 bashkitë. "Ne ende nuk e kemi diskutuar këtë çështje, në parim jemi të hapur për të bashkëpunuar me të gjithë spektrin opozitar", u shpreh Spaho në një prononcim për "Vizon Plus". Nga ana e tij, kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili tha: "Shqipëria po përballlet me një rrezik të madh. Pa u ndërgjegjësuar për një çështje të tillë, të gjitha koalicionet qofshin edhe me ndonjë fitore këtu-atje, apo çdo lloj fitoreje do të ishte e pavlerë përballë një Shqipërie që rënohet e shkatërrohet".



**PROTESTAT**

Pjesë e aksionit opozitar do të jenë edhe protestat, por të dyja partitë kanë vendosur që përkohësisht të mos zhvillojnë asnjë të tillë përsa kohë që vendi pret të hapë negociatat për anëtarësim, për të mos dëmtuar procesin e integritimit.

het". Sipas Spahos, të gjitha partitë opozitare do të fokusohen drejt një aksioni të përbashkët, që nis nga parlamenti e shkon deri tek këshillat bashkiakë. "Si opozitë do të koordinojmë më mirë se deri më sot edhe në Kuvendin e Shqipërisë. Bashkëpunim ka pasur edhe deri më tani, por do të jetë në mënyrë më të strukturuar. Sikurse do të rritet bashkëpunimi edhe në këshillat bashkiakë, madje edhe midis

strukturave partiake në nivel vendor", u shpreh kreu i grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho. "Çështje kryesore tek të cilat do të fokusohet ky bashkëpunim janë problematikat më të mëprehta me të cilat përballlet vendi", tha ai. Sipas Petrit Vasilit, "qëndrimi ndaj kimit të organizuar dhe trafikut të drogës, i cili po bëhet shkatërrues i ekonomisë, por edhe i imazhit të vendit. Së dyti, nëpërmjet

Komisionit të Reformës Zgjedhore për të rivendosur institucionin e votës së lire dhe së treti, për të ndaluar politikën shkatërrimtare ekonomike siç janë koncesionet". Pjesë e aksionit opozitar do të jenë edhe protestat, por të dyja partitë kanë vendosur që përkohësisht të mos zhvillojnë asnjë të tillë përsa kohë që vendi pret të hapë negociatat për anëtarësim, për të mos dëmtuar procesin e integritimit. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi deklaroi disa ditë më parë se gjatë kësaj periudhe deri në marrjen e një vendimi nga Brukseli, do t'i lënë në dispozicion qeverisë të gjithë kohën e nevojshme, jo për t'i bërë nder Edi Ramës, por qytetarëve të vendit, të cilët meritojnë hapjen e negociatave.

**Deputeti**

**EDMOND SPAHO**

"Si opozitë do të koordinojmë më mirë se deri më sot edhe në Kuvendin e Shqipërisë. Bashkëpunim ka pasur edhe deri më tani, por do të jetë në mënyrë më të strukturuar. Sikurse do të rritet bashkëpunimi edhe në këshillat bashkiakë, madje edhe midis strukturave partiake në nivel vendor", u shpreh kreu i grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho.

**TAKIMI**

**Kryeministri në Vlorë: Do të vëmë në punë aeroportin e Kukësit me çmimet më të lira**

Kryeministri Edi Rama lajmëroi dje se shqiptarët do të fluturojnë më lirë nga aeroporti i Kukësit. Ndërsa në Kukës po për gatitje fillimi i protestës për taksën në Rrugën e Kombit, kryeministri Edi Rama nga Vlora tha se qeveria po punon për të hapur aeroportin e Kukësit, të cilin do t'i garantohet një fluks i lartë, për shkak të tarifave të ulëta të fluturimit. "Qeveria po vijon negociatat për vënien në punë sa më shpejt të aeroportit të Kukësit. Ky aeroport do t'i shërbejë një hapësirë shumë të rëndësishme shqiptare dhe është një aeroport që do të jetë i garantuar me një fluks të lartë, pasi do të mbulojë të gjitha fluturimet me Anglinë, Gjermaninë, Zvicrën dhe zonat ku ka shumë shqiptarë. Pa llogaritur pastaj edhe shqiptarët e Kosovës, që do ta kenë shumë më të lehtë të përdorin aeroportin e Kukësit, si rezultat i çmimeve të ulëta", deklaroi Rama. Ai foli gjithashtu për një tjetër rrugë me pagesë. Rama tha se së shpejti mund të nisë një projekt i ri për rrugën që lidh Kashar-Rrogozhinë-Vlorë. "Kemi shpresoj edhe mundësinë për të filluar me projektin Kashar-Rrogozhinë-Vlorë, në mënyrë që lidhja të bëhet direkte dhe aty do të synojmë një tjetër skemë. Pra, kemi skemat e PPP, këtu do të kemi skemën e buxhetit dhe aty do të kemi skemën e pagesës. Pra, me një rrugë me pagesë që t'i mund të vish nga Tirana në Vlorë për gjysmën e kohës që vjen sot. Kush do të paguajë, paguan; kush s'do të paguajë, kalon vazhdon jetën siç bën sot. Kjo është rruga", tha Rama. Gjatë takimit me vlonjatët, Rama ironizoi kërkesat që i kanë ardhur edhe nga socialistë të Vlorës për punësim në shtet.

Pagesat për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist

Ornela Manjani

# Financat çelin fondin për pagesat e të përndjekurve

Lista me përfituesit që duhet të aktivizojnë llogaritë brenda 15 ditësh

Ministria e Financave çel fondin për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë. Është publikuar dhe lista emërore e përfituesve, të cilëve i ka kaluar pagesa në bankë dhe duhet të depozitojnë numra llogarie të rinj në të njëjtën bankë (sepse ekzistueset janë mbyllur nga bankat). Afati për t'i dorëzuar numrat e llogarive aktive është 15 ditë dhe llogaritet nga data 30.03.2018.

## PËRFITUESIT QË JETOJNË

Sipas rasteve dhe radhës së trashëgimisë, dokumentet e nevojshme për të përfituar dëmshpërblim për ish-të dënuarit që jetojnë duhet janë, numër llogarie aktive në një bankë të nivelit të dytë. Ndërsa për trashëgimtarët e ish-të përndjekurve që nuk jetojnë duhet një akt trashëgimie, certifikatë vdekjeje të të dënuarit, certifikatë trungru të të dënuarit, numër llogarie bankare aktive për çdo përfitues ose prokurë dhe dokument identifikimi për përfituesit. Në qoftë se njëri ose disa trashëgimtarë të radhës së dytë nuk jetojnë më, e drejta e tyre për dëmshpërblim në bazë të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 (ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009) nuk vazhdon më tej. Në këtë rast, llogaritja e pjesës takuese të kështit bëhet mbi bazën e trashëgimtarëve që janë gjallë. Nga ana e trashëgimtarëve që jetojnë,

në marrëveshje, paraqesin certifikatën e vdekjes së trashëgimtarit që nuk jeton, të cilën e postojnë së bashku me numrin e dosjes. Ministria e Financave bën të ditur se në rastet kur ish-i përndjekuri nuk jeton më, një dosje quhet e rregullt dhe e gatshme për t'u paguar, vetëm atëherë kur të gjithë trashëgimtarët pa përjashtim, do të kenë dorëzuar (postuar) dokumentacionin e përmendur më lart për të gjitha rastet e trashëgimisë. Në të kundërt, askush nuk mund të paguhet i veçantë, derisa i gjithë dokumentacioni i dosjes të jetë i plotë për të gjithë.

## KATEGORITË PRIORITARE

Të parat në listë janë gratë e ish-të dënuara që jetojnë në momentin e pagesës. Përfituesit duhet të paraqesin certifikatë personale jo më e vjetër se një javë nga data e dorëzimit dhe numër llogarie bankare në lek në njërin nga bankat e nivelit

### KRITERET PËR TË PËRFITUAR DËMSPËRBLIM

- I dënuari ose familjarët e viktimave të dënuara, të ekzekutuara apo të pushkatuara, për të përfituar dëmshpërblim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Të jetë dënuar me dënim kapital, heqje lirie, internim dhe dënim apo të jetë izoluar në hetuesi ose në një institucion mjekësor psikiatrik, për shkak të një vendimi gjykatë të formës së prerë, të një akti administrativ apo të urdhrave të hetuesisë, të dhëna gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991.
  - b) Heqja e lirisë, izolimi në hetuesi apo në një institucion mjekësor psikiatrik, me vendim gjyqësor të formës së prerë apo me urdhër të hetuesisë, të jetë për shkak të një vepr penale politike, siç përcaktohet në nenin 5 të këtij ligji.
  - c) Të ketë kryer ose të ketë vuajtur dënim penal të padrejtë plotësisht ose pjesërisht;
  - d) Të kenë fituar pajfajësinë, sipas ligjit nr. 7541, datë 30.09.1991 "Për pajfajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", të ndryshuar.
  - e) Sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, të mos ketë kryer veprime të dëmshme, me pasoja për jetën e shtetasve të tjerë gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 01.10.1991.

të dytë, që vepron brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Sipas urdhrat të

Ministrisë së Financave, në kategorinë e dytë me prioritet janë persona ish-të dënu

ar mbi 75 vjeç në datën e hyrjes në fuqi të ligjit që vazhdojnë të jenë gjallë. Kjo kategori duhet të paraqesin certifikatë personale jo më e vjetër se një javë nga data e dorëzimit dhe numrin e llogarisë. Ndërsa në kategorinë e tretë me prioritet janë persona ish-të dënuar politikë të gjallë që vuajnë nga sëmundje të rënda. Kjo kategori duhet të paraqesin raport mjeko-ligjor, origjinal me emra dhe mbiemra të anëtarëve me firmë të gjithsecilit dhe me vulë, (jo kopje) për paftësi të plotë për punë e lëshuar nga KEMCAP, raport mjeko-ligjor për sëmundje onkologjike dhe sëmundje të gjakut të pashërueshme të lëshuar nga Qendra Shëndetësore Universitare "Nënë Tereza", Qendra Shëndetësore Universitare "Shefqet Ndroqi", certifikatë personale dhe numrin e llogarisë bankare në lek. Kategoria e katërt me prioritet janë persona ish-të dënuar që janë gjallë, të cilët

pavarësisht moshës në momentin e pagesës kanë trashëgimtarë të radhës së parë në moshë të mitur nën 18 vjeç. Përfituesit e kësaj kategorie duhet të paraqesin certifikatë personale jo më e vjetër sesa një javë nga data e dorëzimit, certifikatë familjare ku të përfshihet fëmija i mitur, certifikatë personale të fëmijës/fëmijëve të mitur dhe numër llogarie bankare në lek. Ndërsa, për kategorinë e pestë me prioritet, "Për persona ish-të dënuar që nuk jetojnë, por në momentin e pagesës kanë trashëgimtarë të radhës së parë në moshë të mitur nën 18 vjeç". Përfituesit duhet të paraqesin certifikatë vdekjeje të personit ish-të dënuar, certifikatë personale e të miturit/miturëve, trashëgimtarë të radhës së parë të personit ish-të dënuar që nuk jeton më, certifikatë familjare të ish-të dënuarit ku të përfshihen fëmija/fëmijët e mitur, dëshmi trashëgimie që të vërtetojë se fëmija i mitur është trashëgimtar ligjor. Vendim gjykatë të kujdestarisë mbi të miturin në rastin kur edhe nëna e të miturit nuk jeton më dhe numër llogarie bankare. Për kategorinë e gjashtë me prioritet, "Për persona ish-të dënuar që janë gjallë dhe në momentin e pagesës nuk kanë mbushur 75 vjeç", të cilët duhet të dorëzojnë certifikatë personale jo më e vjetër se një javë nga data e dorëzimit dhe numër llogarie.

## PËRFITUESIT I KANË KALUAR LEKËT NË BANKË, POR NUMRAT E LLOGARISË SË TYRE REZULTOJNË TË MBYLLUR

Emër Mbiemër	Nr. Llogarie	Gjendja e llogarisë	Kanarina Bashari	2404680	LLOGARIA E MBYLLUR	Shpresa Papaj	442593	LLOGARIA E MBYLLUR
Skender Jaupaj	136677	LLOGARIA E MBYLLUR	Klorinda Gokaj	541302	LLOGARIA E MBYLLUR	Sokrat Kushi	11068025	LLOGARIA E MBYLLUR
Fitim Meta	916451	LLOGARIA E MBYLLUR	Kolë Deda	891608	LLOGARIA E MBYLLUR	Suzana Baba	603405	LLOGARIA E MBYLLUR
Gezim Ulaj	0110333971	LLOGARIA E MBYLLUR	Kostandine Qirollari	901692	LLOGARIA E MBYLLUR	Taip Hoxha	316397	LLOGARIA E MBYLLUR
Adelina Guzi	10118168	LLOGARIA E MBYLLUR	Kristofor Stefanidhi	13946	LLOGARIA E MBYLLUR	Vahide Gokaj	233258	LLOGARIA E MBYLLUR
Agron Zeneli	298688	LLOGARIA E MBYLLUR	Lazër Bushati	2326745	LLOGARIA E MBYLLUR	Valentina Gaci	782181	LLOGARIA E MBYLLUR
Aida Kurti	40487536	LLOGARIA E MBYLLUR	Lindita Dano	776202	LLOGARIA E MBYLLUR	Vera Shaqe	440346	LLOGARIA E MBYLLUR
Alberta Gega	739779	LLOGARIA E MBYLLUR	Merita Omari	2691188	LLOGARIA E MBYLLUR	Violeta Xhangolli	11042329	LLOGARIA E MBYLLUR
Aleksandra Billaci	32007	LLOGARIA E MBYLLUR	Mrike Mhillaj	474533	LLOGARIA E MBYLLUR	Vjollca Zoga	775864	LLOGARIA E MBYLLUR
Antonjeta Perdja	742239	LLOGARIA E MBYLLUR	Muhamet Xhaferri	65249	LLOGARIA E MBYLLUR	Xhemile Cela	322439	LLOGARIA E MBYLLUR
Astrit Odoku	352668	LLOGARIA E MBYLLUR	Mustafa Tabaku	16508	LLOGARIA E MBYLLUR	Zalide Cala	285887	LLOGARIA E MBYLLUR
Barije Isa	1045551	LLOGARIA E MBYLLUR	Myriban Besimi	514931	LLOGARIA E MBYLLUR	Zana Kullolli	284596	LLOGARIA E MBYLLUR
Behari Saliaj	3246607	LLOGARIA E MBYLLUR	Nadire Cala	300577	LLOGARIA E MBYLLUR	Zyra Gjolena	285677	LLOGARIA E MBYLLUR
Drita Darzeza	285304	LLOGARIA E MBYLLUR	Nest Keraj	400027308	LLOGARIA E MBYLLUR	Çesk Deda	600487	LLOGARIA E MBYLLUR
Durim Iljazi	107049	LLOGARIA E MBYLLUR	Nuri Haxhi	103692	LLOGARIA E MBYLLUR	MARGARITA ILIA	717891	LLOGARIA E MBYLLUR
Efikat Marko	615078	LLOGARIA E MBYLLUR	Ormir Rusi	1401688355	LLOGARIA E MBYLLUR	BASHKIM MURRIZI	2700417985	LLOGARIA E MBYLLUR
Elisaveta Marini	251339	LLOGARIA E MBYLLUR	Pellumbesha Ndreu	377599	LLOGARIA E MBYLLUR	EQEREM SALIAJ	11064566	LLOGARIA E MBYLLUR
Ernest Bushati	667329	LLOGARIA E MBYLLUR	Pjerin Mirashi	1003637	LLOGARIA E MBYLLUR	LUTFI SHOTI	11090194	LLOGARIA E MBYLLUR
Esat Haxhi	616277	LLOGARIA E MBYLLUR	Portokalle Kullolli	311379	LLOGARIA E MBYLLUR	SANIJE HALILI	1061879	LLOGARIA E MBYLLUR
Fatbardha Lekaj	1401691299	LLOGARIA E MBYLLUR	Qemal Zeneli	797601	LLOGARIA E MBYLLUR	Anastas Zeneli	1021842	LLOGARIA E MBYLLUR
Fatmir Zeneli	297995	LLOGARIA E MBYLLUR	Rabihan Myzaferri	195961	LLOGARIA E MBYLLUR	Beglie Uka	820525	LLOGARIA E MBYLLUR
Ferdinand Zdrava	1574843	LLOGARIA E MBYLLUR	Ramadan Sheri	442566	LLOGARIA E MBYLLUR	Diturije Shaqlli	1153833	LLOGARIA E MBYLLUR
Fiqirije Lami	1582691	LLOGARIA E MBYLLUR	Ramadan Kocibelli	37832	LLOGARIA E MBYLLUR	Fatmir Zeneli	1021920	LLOGARIA E MBYLLUR
Flamure Nebiu	1229527	LLOGARIA E MBYLLUR	Ramis Haxhi	105161	LLOGARIA E MBYLLUR	Jusuf Çekju	11092042	LLOGARIA E MBYLLUR
Hajdar Saliaj	1633842	LLOGARIA E MBYLLUR	Regjina Pipan	782208	LLOGARIA E MBYLLUR	Paulin Macaj	1051875	LLOGARIA E MBYLLUR
Ilvira Fezullau	286715	LLOGARIA E MBYLLUR	Sandër Deda	537138	LLOGARIA E MBYLLUR	Shpëtim Çela	3205321	LLOGARIA E MBYLLUR
Ismail Zeneli	822037	LLOGARIA E MBYLLUR	Serjoze Sulko	358184	LLOGARIA E MBYLLUR	Vera Shaqe	440346	LLOGARIA E MBYLLUR
Jani Danga	249980	LLOGARIA E MBYLLUR	Shejnaz Lamcja (Cerriku)	0011012201	LLOGARIA E MBYLLUR	Zhani Qirjo	2800673	LLOGARIA E MBYLLUR
Jorgo Zeneli	5011957	LLOGARIA E MBYLLUR						

## DIPLOMACI CEREMONIA

Mbahet koncerti "Bota turke me të gjitha ngjyrat e saj" në kuadër të festimeve të Nevruzit

# Kryekëshilltari i Erdoganit: Turqia promovon vëllazërinë dhe paqen

Jallçën Topçu në Tiranë: Siguri në çdo vend

Me rastin e "Sulltan Novruzit", festes së ringjalljes së natyrës, Ambasada Turke në Tiranë organizoi një koncert të titulluar "Bota turke me të gjitha ngjyrat e saj", ngjyra të cilat u pasqyruan me interpretimet e 70 artistëve nga 10 shtete. Artistët nga vende të ndryshme të botës që e krenojnë këtë festë pasqyruan nëpërmjet artit të tyre, pasurinë e përbashkët të botës turke.

Kryekëshilltari i Presidentit të Republikës turke, Jallçën Topçu përcolli përshëndetjet e presidentit Rexhep Taip Erdogan dhe tha se me anë të këtyre festimeve tregohet si Turqia promovon vëllazërinë dhe paqen. Për promovimin e gjuhës dhe kulturës turke nëpërmjet këtij aktiviteti, u angazhuan instituti "Yunus Emre", i cili shërben si një urë lidhëse për kultura të ndryshme si edhe organizata ndërkombëtare kulturore turke "Turksol".

Festimet për Novruzin janë bërë në 5 vende të ndryshme të Ballkanit. Në 2009 UNESCO e përfshiu festën e Sulltan Novruzit në listën e trashëgimisë kulturore jomateriale.

Instituti "Yunus Emre" dhe Organizata Ndërkombëtare e Kulturës Turke (TÜRKSÖY), nën kujdesin e Ambasadës së Republikës së Turqisë në Tiranë kanë organizuar koncertin "Bota turke me të gjitha ngjyrat e saj" në kuadër të festimeve të Nevruzit, me pjesëmarrjen e dhjetëra artistëve nga vende të ndryshme.

Mes qytetarëve të shumtë, pjesë e aktivitetit ishin Jallçën Topçu, kryekëshilltari i Presidentit të Republikës së Turqisë, sekretari i Përgjithshëm i TÜRKSÖY, Düsen Kaseinov, president i Institutit "Yunus Emre", prof. dr. "eref Ate", ambasadori i Turqisë në Tiranë, Murat Ahmet Yörük, përfaqësues të institucioneve turke në Shqipëri, përfaqësues të trupit diplomatik në Tiranë, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe të ftuar të tjerë.

President i Institutit "Yunus Emre", prof. dr. "eref Ate", gjatë fjalës së tij përshëndetëse e konsideroi eventin si një shfaqje madhështore, me pjesëmarrjen e 70 artistëve.

"Institutit 'Yunus Emre' është një urë lidhëse për kulturat e vendeve të ndryshme. Filozofia e tolerancës pasqyrohet nëpërmjet gjuhës dhe aktiviteteve kulturore që ne zhvillojmë. Festa e Nevruzit simbolizon ringjallërimin e natyrës dhe shpresojmë që këtë aktivitet



Kryekëshilltari i Presidentit të Republikës turke, Jallçën Topçu



### FESTA E NEVRUZIT

Instituti "Yunus Emre" dhe Organizata Ndërkombëtare e Kulturës Turke, TÜRKSÖY, nën kujdesin e Ambasadës së Republikës së Turqisë në Tiranë kanë organizuar koncertin "Bota turke me të gjitha ngjyrat e saj" në kuadër të festimeve të Nevruzit.

ta pasqyrojmë në shumë vende të ndryshme të botës", tha Ate.

Kryekëshilltari i Presidentit të Republikës së Tur-

qisë, Jallçën Topçu, në emër të popullit turk dhe në emër të presidentit të Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, ka përçjellë përshëndetjet për

të pranishmit në këtë aktivitet. Topçu tha se: "Do të shikoni sesi turqit e kanë sjellë vëllazërinë, paqen dhe sigurinë nga Azia në vendet e tjera. Me këtë shfaqje do të shikoni qytetërimin turk".

Ndërsa sekretari i Përgjithshëm i TÜRKSÖY, Düsen Kaseinov, tha se këtë vit festimet e Nevruzit i kanë realizuar në pesë vende të Ballkanit, duke shtuar se artistët pjesëmarrës pasqyrojnë ngjyrat e botës turke. "Së bashku me artistët



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,604,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në itlogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttes: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **24 Prill 2018**, ora **11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

pasqyrojmë të gjithë pasurinë e kulturës sonë të përbashkët, theksoi Kaseinov.

Në aktivitet u përçollën mesazhet se Nevruzit është festuar si festë e mirëkuptimit dhe paqes në botë. Artdashësit shqiptarë ndoqën performancën e arti-

stëve me këngë dhe valle, duke u njohur nga afër me traditat, muzikën dhe veshjet karakteristike të vendeve të botës turke. Në event morën pjesë artistë nga Turqia, Azerbajxhani, Kazakistan, Kirgistani, Uzbekistani, Fede-rata Ruse, etj.

STRATI

Shoqëria përmbartore "STRATI BAIIFF'S SERVICE" Sh.p.k. rrijton shpalljen për shërbim në ankaditë pasurive të paluajtshme:

"Pylil", me sipërfaqe 6000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 82, regjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyze-BLS" sh.a. lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2167 Rep. Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 15,120,000 Lekë;  
"Pylil", me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 81, regjistruar në pronësi të Ylli Braha dhe Emira Braha, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2167 Rep. Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 2,520,000 Lekë;  
"Truall", me sipërfaqe 2497 m<sup>2</sup>, nga e cila 2497 m<sup>2</sup> truall dhe 161 m<sup>2</sup> ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumni 4, faqe 247, regjistruar në pronësi të Armand Shuqazi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2173 Rep. Nr. 1409/2 Kol., datë 24.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 133,065.6 Lekë;  
"Arë-Truall", me sipërfaqe 4,500 m<sup>2</sup>, nga e cila 400 m<sup>2</sup> truall dhe 176 m<sup>2</sup> ndërtesë, ndodhur në Sallimone, Durrës, me Nr. 1781/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumni 6, faqe 135, regjistruar në pronësi të Bajram Gjyzezi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 657 Rep. Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipotekore Nr. 1512 Rep. Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 9,534,672 Lekë;  
"Dygan", me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rruga e Durrësit, Tiranë, Zona Kadastrale 8310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 518, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqëria "LIM-EM" sh.p.k. lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 1201 Rep. Nr. 800/3 Kol., datë 13.03.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 53,424 Euro.

Ankaditë për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.04.2018. Ankaditë për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqëria Përmbartore "Strati Baiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibaiff.com, info@stratibaiff.com



Agjencia e Trajtimit të Pronave: Përfituesit kanë edhe 4 muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar në të gjithë vendin. Në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, generalitetet e subjekteve të shpronësuar, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësimin e detajuar për çdo dosje. Numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar dhe që janë vlerësuar

# Lista V/ Vendimet e vitit 1997, emrat e 1462 pronarëve që kompensohen

Kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitet 1993-1997 rreth 17 318 vendime

financiarisht e publikuar nga ATP-ja është 17 318 vendime. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e vitit 1997 së bashku me vlerën financiare.

## MUNGESA E DOKUMENTACIONIT

Sipas ATP-së, në rastet kur subjektet e interesuara nuk sjellin dokumentacion të nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimit të kompensimit brenda afatit 6-mujor nga data e publikimit të regjistrimit, si dhe në rastet

kur ATP-ja është në pamundësi objektive për të vlerësuar pronën, bazuar në dokumentacionin që disponon vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht. Pronarët kanë edhe 4 muaj kohë për plotësimin e dokumenteve dhe ATP njofton të gjitha subjektet, që për çdo informacion apo paqartësi lidhur me të dhënat e publikuara në regjistrim apo që nuk i gjejnë të publikuara në të, mund të paraqiten pranë sporteveve tona për sqarime dhe informacion

më të detajuar. Gjithashtu, ATP ka filluar punën dhe së shpejti do të përfundojë procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të vitit 1998 dhe në vijim sipas rendit kronologjik do të vlerësohen të gjitha vendimet, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## DOSET E PËRFUNDUARA

Me përfundimin e procesit të vlerësimit financiar të

vendimeve përfundimtare të vitit 1997, si dhe nga përditësimi i regjistrimit të vendimeve për vitet 1993-1996, numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP është 17 318 vendime. ATP, nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.133/2015 e deri më tani ka përfunduar vlerësimin financiar për 67% të të gjithë

vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me ecurinë e punës së deritanishme, kjo falë edhe sistemit "Web-Gis" të implementuar nga ATP, ky proces parashikohet të përmbyllet përpara afatit të përcaktuar në ligj për përfundimin e vlerësimit financiar të të gjitha vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

## EMRAT E 1462 PRONARËVE QË KOMPENSOHEN

Tiranë	Remzije Kraishta , Shahe	1,133,927
Tiranë	Ali Tirana, Lila Tirana	907,425
Tiranë	HANE BODLLI	1,271,547
Tiranë	Fitnete Sinka, Nexhip Ali	1,929,626
Tiranë	MAIRA PAZARI	3,893,056
Tiranë	SULEJMAN KEZI	
Tiranë	ANDREA GANI	
Tiranë	QAZIM, ABAZ, FADIL	1,159,415
Tiranë	Drita Merkja, Mehmet Merkja	
Tiranë	Isuf Rosa	741,137
Tiranë	Merita Becerri, Vasip Becerri	
Tiranë	Zyber Bushi	71,310
Gjirokastrë	Kanan Ali Dervishi	
Gjirokastrë	Pashako Guma	96,237
Dibër	RUSTEM VRANIÇI	
Dibër	BARDHYL MAZARI	106,375
Korçë	Hamit Kasolli	
Fier	Xhemil Haxhaj	
Gjirokastrë	Zonje Guma	
Korçë	Saip Biba	402,675
Tiranë	MUHARREM MAHMUDI	-1,899,880
Tiranë	XHAFER DARDHA	-1,791,710
Fier	Hekuran Bideri	
Fier	Barjam Barjami	
Fier	Kaso Zotaj	
Fier	Nateme Velaj	-550,000
Fier	Jonuz Brahimaj	
Fier	Muharrem Avdiaj	
Korçë	Ollga Tabaku	1,807,110
Korçë	Qerim Nake	121,088

Vlorë	Mukadez Sulejmani	94,160
Vlorë	Neshat Osmani	363,440
Berat	Iljaz Metani	1,292,114
Berat	Isuf Nuellari	0
Fier	Beqo Hoxha	1,768,868
Berat	Hajder Hysi	2,723,000
Gjirokastrë	Jonuz Naci	
Korçë	Demir Keco	169,136
Korçë	Hekuran Xhango	191,881
Korçë	Islam Asllan Myrte	1,527,696
Korçë		2,274,738
Korçë		
Korçë	BEQIR BYLYKBASHI	533,813
Tiranë	MUSA AHMET SUDI	1,168,720
Tiranë	HAMDİ REKA	
Vlorë	Baftjar Caushi	325,741
Vlorë	Petref Haxhiraj	4,711,136
Vlorë	Engjell Runa	3,678,278
Vlorë	Kojdhe I Saraj	4,986,170
Vlorë	Bilbil Labaj	271,238
Vlorë	Bektash Tahiraj	628,137
Vlorë	Fadil Capo	
Vlorë	Serri Kurti	13,260,000
Vlorë	Demir Islamaj	1,161,338
Vlorë	Mitat Bellaj	2,838,197
Vlorë	Iljaz Iljazi	566,506
Korçë	Ferit Ago	680,219
Korçë	Pandi Zhato	1,574,065
Korçë	Pleurat Caco	2,078,073
Tiranë	HAJDARI	
Tiranë	HASAN RAMAZAN BOGDANI	

Tiranë	THACI	
Korçë	Lyti Berberi	
Elbasan	ADHURIM KAOLI	
Elbasan	MEHMET BALLKOCI	256,881
Gjirokastrë	Hajri Bilo Llakaj	773,007
Korçë	Feim Pasho	1,096,875
Durrës	Nazmi Shehi	
Lezhë	Mark Frok Gjeci	686,944
Lezhë	Preng Mark Prenga	282,129
Lezhë	Dede Ndue Gjeci	
Lezhë	Pashk Nikoll Prendi	
Durrës	Ramazan Çopa	
Durrës	Vjollca Dedja	4,407,000
Korçë	Mitat Mero	
Durrës	Vita Mazniku	-530,400
Gjirokastrë	Shaje Allkaj	
Durrës	Abdulla Shehi	
Korçë	Nevruz Subashi	2,054,088
Fier	Llazar Koço	2,072,317
Fier	Sokrat Naçi	3,121,119
Fier	Ndoni Silo	6,089,030
Fier	Nimete Mala	
Fier	Refat Selfo	2,021,021
Fier	Hidajet Mala	1,170,475
Fier	Hysen Malaj	
Fier	Miti Janku	8,591,494
Korçë	Mitika Uci	
Korçë		477,960
Lezhë	Gjyste Leshi	387,251
Fier	Nikollaq Llço	
Durrës	Hamid Balla	2,738,574

Gjirokastër	Bashkim Shytaj	
Durrës	Rifat Shkodra	6,840,147
Durrës	Ismail Meça	10,504,858
Durrës	Hatixhe Dani	649,782
Korçë	LUAN KOLAMI	-232,552
Korçë	Teki Gegolli	
Korçë	Eqerem Avxhi	103,530
Dibër	BARDHYL KADIU	3,088,739
Lezhë	Frok Llesh Recë	-2,768,525
Lezhë	Gjon Mark Recë	2,845,484
Tiranë	Besnik Bashmeta, Halil Bashmeta	
Tiranë	RAMIZ CELA	329,000
Tiranë	XHEMILE MALIQATI	3,948,000
Tiranë	HAMIDE KOKA	
Tiranë	Kadife Dedej(Dervishi)	723,552
Tiranë	MEREME XHAHYSA (B)	414,829
Tiranë	Drita Gashi, Feride Gash	1,570,913
Tiranë	ANISHA HENCI	3,190,836
Tiranë	Mereme Hoti ( Boletini ),	1,197,704
Tiranë	Sadete Hadja, Shyqyri H	2,585,000
Tiranë	FATIME, OLIMBI KUM	7,502,418
Tiranë	HATIXHE CELPICA	3,026,800
Tiranë	Ali Thertori	659,569
Tiranë	Haxhi Hallulli, Shefqet Hal	1,826,812
Tiranë	Arta Fagu	3,424,805
Tiranë	Ramiz Çela	458,066
Tiranë	Ramiz Cara	5,317,211
Dibër	Qemal Allamani	2,055,808
Korçë	Hasan Emin Skerma	2,551,030
Vlorë	Astrit Kallapodhi	
Korçë	Zikuli Karanxha	55,987
Dibër	Ramazan Ceku	
Korçë	Yzret Meço	232,068
Korçë	Viktor Konomi	-12,669
Vlorë	Myzejen Zejnati	
Fier	Shefqet Buzi	7,682,923
Fier	Thoma Haxhistasa	
Fier	Thanas Duda	9,173,566
Fier	Bilbil Kerri	
Fier	Hysen Çoçoli	
Fier	Përparim Alizoti	3,121,268
Gjirokastër	Spartak Xhuvani	-413,340
Gjirokastër	Shezai Shehu	323,182
Gjirokastër	Kristaq Çipi	
Gjirokastër	Foni Dilo	73,800
Korçë	Gurtali Fezoll	
Korçë	Kostandina Ktona	
Korçë	Xhevdet Dervishi	675,710
Korçë	Kujtim Demko	99,500
Korçë	Shpëtim Çausllari	254,400
Korçë	Ropi Shurdhi	-18,458
Korçë	Ibrahim Qose	240,000
Korçë	Novruz Pino	190,000

Korçë	Bajram Pane	
Korçë	Vangjel Pelteku	773,500
Korçë	Shpetim Iliri	400,000
Elbasan	MUHAMET GJONI	165,749
Elbasan	XHEMAL STOJKU	1,633,731
Korçë	Kadrije Agolli	219,272
Korçë		1,010,000
Elbasan	DEMIR REXHEPI	
Vlorë	Koco Kristo	
Vlorë	skender Godo	
Korçë	Vasfi Staro	
Korçë	Gurali Dervishllari	
Korçë	Vasfi Nevrus	3,924,912
Vlorë	Vasil Dharmi	54,912
Korçë	Ylli Sulo	1,398,086
Korçë	Xhelal Vasha	1,289,030
Durrës	Sanije Hoti	-2,275,000
Durrës	Bahtije Feri	2,925,000
Durrës	Hysen Dizdari	936,000
Durrës	Jovan Prifti	
Durrës	Ramazan Dika	862,000
Durrës	Fadil Feri	
Gjirokastër	Poli Xhello	55,770
Korçë	Gjergji Shkurti	
Korçë	Eleni Fushi	643,500
Korçë	AHMET ÇETA	
Korçë	Nuri Pleku	261,180
Tiranë	HYKA	1,719,366
Gjirokastër	Novruz Varfi	
Korçë	Selami Elezi	1,010,207
Korçë	Sotir Robo	523,119
Korçë	Avdulla Myteveli	1,958,607
Korçë	Neki Kroj	1,356,211
Korçë	Guri Tili	278,500
Korçë	Qani Lazellu	147,926
Korçë	Sefër Kacka	413,108
Korçë	Bedri Spahllari	2,124,536
Korçë	Ramadan Hysollari	
Korçë	Teki Kodrasi	497,558
Berat	NURI ÇONGO	877,968
Berat	NURI ÇONGO	380,367
Berat	Qemal Alushani	35,138
Berat	Qemal Alushani	585,630
Berat	Fatime Llango	1,423,829
Berat	Bido Duçellari	1,683,665
Berat	Xhevdet Molla	3,478,642
Korçë	Demirali Collaku	2,140,803
Gjirokastër	Qani Veiz Jençeraj	3,150,256
Korçë	Kristo Plaku	11,304,583
Durrës	Ibrahim Halili	1,063,654
Durrës	Shaban Kurti	3,738,252
Durrës	Mehmet Hoxha	
Elbasan	XHAZAI SULOLLARI	583,129
Elbasan	RAKIPE ZENEL GURR,	129,571

Gjirokastër	Vangjel Angjeli	72,421
Dibër	SHAQIR KOKA	
Korçë	Radium Avxhi	306,000
Dibër	LIHE PALI	
Korçë	Huan Agolli	1,011,000
Dibër	MYFTAR SINANI	3,660,480
Korçë	Lazar Morcka	
Korçë	Viktor Xhelati	440,000
Korçë	Fehim Aska	223,000
Korçë	Qerim Tahiri	71,500
Dibër	DYLEJMAN TUSHA	
Korçë	Adem Imami	150,000
Korçë	Xhelil Xhaholli	
Korçë	Valentina Duçi	142,560
Korçë	Vasil Jani	636,000
Korçë	Ollga Xhelo	
Korçë	Gaqo Koroveshti	91,065
Korçë	Safet Bashtani	
Korçë	Aferdita Spaho	
Korçë	Hekuran Bashllari	0
Lezhë	Gjet Mamli	0
Korçë	Sotir Ruço	1,874,400
Gjirokastër	Aferdita Xhitomi	
Dibër	Fiqiri Çuka	
Gjirokastër	Qeriba Gjylaj	
Korçë	Ismail Hanelli	174,821
Korçë	Yhviqe Talelli	250,357
Korçë	Hysen Shutko	
Korçë	Vasil Morcka	450,753
Korçë	Shyqyri Hoxhalli	453,907
Korçë	Nefi Bacelli	212,929
Korçë	Shyqyrie Abedini	98,802
Korçë	Selvika Ziu	168,095
Korçë	Andon Naumi	273,294
Korçë	Bari Sulollari	
Korçë	Medat Mero	5,827,721
Korçë	Gjergj Nikolli	1,431,560
Korçë	Hysen Lipo	394,474
Korçë	Servet Lari	1,376,491
Korçë	Hekuran Zenelaku	653,973
Korçë		468,504
Korçë	Zani Barolli	214,041
Korçë	Mazlem Zypçe	222,539
Dibër	ZABIT AHMET BICI	23,115
Dibër	TAHIR RAMADAN ZENELI	
Dibër	AGIM GJOKA	335,097
Korçë	Nazif Shaholli	17,408
Korçë	Gurazi Demiraj	420,339
Korçë	Adem Abidin	1,710,040
Korçë	Leonard Pasterma	778,302
Lezhë	Bardh Ndoji	292,485
Vlorë	Bastri Hasani	0

Lezhë	Kol Zef Gjinaj	193,128
Gjirokastrë	Petrit Maliq Sinomataj	
Korçë	Ibrahim Subashi	858,280
Korçë	Hekuran Gjiriti	1,054,134
Korçë	Spiro Sorba	324,916
Korçë	LLAZI KOVACI	-255,200
Korçë	Skënder Shkëmbi	460,800
Korçë	Gjergji Burda	
Korçë	Ligor Mançe	20,000
Korçë	Janulla Gjata	33,200
Korçë	Hajrije Lisi	100,000
Korçë	Ajdin Mecollari	400,000
Korçë	Jonel Nasto	432,870
Korçë	Todi Çollaku	47,322
Korçë	Dalip Shkëmbi	66,500
Korçë	Fevri Bylykbashi	55,400
Korçë	Shenjtor Hoxhalli	91,408
Korçë	Ylber Mullalli	31,520
Korçë	Engjell Bushi	0
Korçë	Hekuran Mullalli	418,000
Korçë	Xhevat Agolli	1,567,744
Tiranë	HAKI XHAJA	-75,775
Tiranë	KOMUNITETI MYSLY	-1,494,400
Korçë	Xhemal Qyteza	374,724
Korçë	Kisha Ortodokse	584,800
Korçë	PETRI TOMORRI	123,633
Korçë	Petraq Pine	907,727
Korçë	LEFKOTHE PETE	190,330
Korçë	Medeat Bylyku	
Korçë	Nafiz Tale	570,256
Korçë		1,335,236
Shkodër	Hydajet Kuqi	
Gjirokastrë	Fejzo Zaçaj	
Gjirokastrë	Xhafer Beqo Osmani	338,616
Korçë	Fadile Spaho	818,537
Korçë	Leni Rado	321,745
Korçë	Sotir Toçe	146,408
Korçë	Vangjel Morcka	333,809
Korçë	Shefki Dalip Malësia	7,509,078
Korçë	Gurali Bacellari	286,959
Korçë	Nevruz Bala	726,669
Korçë	Safet Malelli	1,454,295
Vlorë	Meto Duka	-7,006,940
Korçë	Vangjel Saqellari	5,000,000
Korçë	Vaskë Melo	1,241,392
Korçë	Pandora Minka	1,153,418
Korçë		2,463,858
Korçë	Elise Taluri	279,168
Korçë	Nazar Ismail	1,124,232
Korçë	Hajredin Rusi	
Korçë	Dilaver Baruti	
Korçë	Gezim Sulllari	1,332,308
Kukës	Aslan Qema	
Kukës	Sali Neza	
Kukës	Ali Neza	
Kukës	Sadik Neza	
Durrës	Atthe Hoxha	
Berat	Dalip Mystafaraj	527,067
Korçë	Buajr Bejleri	494,560
Korçë	Mustafa Velu	
Vlorë	Vedat Beqi	-518,800
Korçë	Xhelal Dedelli	-8,507,600
Korçë	Milo Lluka	135,200
Korçë	Avdyll Avdhi	170,000
Korçë	Hysen Oranli	369,900
Korçë	Mustafa Xhahani	98,040
Korçë	Sotiraj Prifti	73,220
Korçë	Nure Kupe	360,000
Korçë	Muharem Kupe	240,000
Korçë	Celnike Kupe	360,000
Korçë	Illa Nasto	
Korçë	Petraq Duni	65,200
Shkodër	Jakup Rroji	12,002,986
Dibër	AHMET LUSHA	
Dibër	RASIM TOMCINI	
Korçë	Fotini Danushi	133,650
Dibër	AQIF ÇAKONI	280,046
Dibër	Hasan Hysen Nika	
Dibër	FERIT BUSHKASHI	
Dibër	HANIFE TROCI	415,125
Dibër	MEHMET SPAHIU	726,415
Dibër	ELMAZ DIKA	3,320,522
Vlorë	Musa Shehu	
Dibër	Fije Vani	731,276
Dibër	Ismail Nel Klosi	1,088,274
Dibër	Qamil Doku	1,496,870
Dibër	Ramadan Çira	305,330
Dibër	Rustem Mcuku	
Dibër	Arif Shulku	-13,631,380
Durrës	Bajram Dana	
Durrës	Skënder Seseri	
Durrës	Agim Picorri	96,264
Elbasan	SKENDER TOROMANI	46,419
Elbasan	HAXHI ZAIMI	147,828
Elbasan	MEHMET HOXHA	2,304,584
Elbasan	FERIT DERMYSHI	1,827,825
Elbasan	SHABAN TOROMANI	949,415
Elbasan	LEFTER NAZARI	322,747
Elbasan	YMER CALA	473,100
Elbasan	HYQMET KACANIKU	2,938,078
Elbasan	BAKI GURI	3,316,466
Elbasan	SELMAN XHELILI	129,270
Elbasan	NURI TACE	238,026
Korçë	Petraq Bushi	133,650
Korçë		2,783
Durrës	Miranda Dulla	
Vlorë	Fatime Mici	-6,305,240
Vlorë	Vasil Lango	
Vlorë		-81,165
Elbasan	SPIRO XHUFKA	6,670,326
Durrës	Shkëlzen Jakova	
Vlorë	Agim Toro	5,907,901
Korçë	Miço Kurila	
Berat	Jaup Katillari	7,938,215
Berat	Aziz Dardha	701,021
Berat	Karafil Arapi	196,203
Korçë	LUAN AGOSTRA	380,925
Tiranë	PETRIT CITAKU	1,976,827
Tiranë	XHEVDET LIBOHOVA (NEKI)	
Tiranë	QAMIL ALLUSHI	5,511,305
Tiranë	SHAQIR ZENELI	5,397,557
Tiranë	MUSA AHMET HERRI	
Tiranë		-10,315,467
Tiranë		647,707
Tiranë	SEFER ALVORA	-8,590,720
Tiranë	TRASHEGIMTARET AL	222,539
Tiranë	ZOJE DEMIRI	1,882,692
Tiranë	XHAFERR AGA	457,100
Tiranë	MAHMUT LOKU	557,496
Gjirokastrë	Qamil Kalaja	121,918
Gjirokastrë	Sotir Saqellari	207,317
Lezhë	Ali Sula	
Dibër	SHABAN ZYBERI	788,172
Korçë	MUHARREM MULLA	
Korçë	Muharrem Mulla	-1,251,075
Dibër	NJAZI SUL TASHA	51,763
Dibër	XHELAL NURÇE BALLIU	
Dibër	SKENDER JASHAR ZENELI	
Dibër	ARBEN QAMIL BALLIU	
Lezhë	Rrok Zef Gjoka	
Kukës	Qamil Sheta	3,042,880
Korçë	Ismail Fero	629,496
Korçë		
Korçë	Oresti Baboci	42,448
Korçë	Adil Sadik	239,842
Lezhë	Prenc Jaku	
Tiranë	ABDULLA ZAJA	1,047,762
Tiranë	MAKBULE SEFA	
Tiranë	METANI	-2,933,760
Tiranë	PETRIT MULLA	2,396,268
Tiranë	HAKI ALIZAJ	693,206
Tiranë	GANI ALLMUÇA	
Tiranë	HYSEN SHEHI	390,820
Tiranë	QAMILE YMERAJ	195,125
Tiranë	XHERACINA SPAHIJA	1,682,374
Korçë		272,781
Korçë		506,310
Korçë		224,593

DEBATI

# NDRENKA, TREBICKA E QIRJAQI

## Kur aktorët i ankoheshin Nanos për Ramën: Do shembë teatrin për një projekt mafioz

Fatmira Nikolli

16 vite më parë, në Tiranë në vitin 2002, artistët që patën luftuar katër vite me radhë me ministrin e Kulturës për çështjen e Teatrit Kombëtar, morën frymë lirshëm, kur ai la ministrinë dhe mori bashkinë.

Megjithëse e menduan veten fitimtarë e armikun të tërhequr, lufta rifilloi, tanimë kundër kreut të bashkisë.

16 vite më vonë, ish-ministri e ish-kreu i bashkisë, është sot kryeministër, e si i tillë, drejton edhe kreun e bashkisë edhe ministrin. Lufta është e njëjta-artistët janë sërish bashkë, por as kundërshtari i kahershëm nuk është vetëm. Është më i fuqishëm se kurrë dhe ka në dorë, bashkinë, ministrinë e qeverinë. Teatri po shkërmoqet, artistët protestojnë, ndërsa projekti i ofruar vjen me godina shtesë e me humbje trualli.

16 vite më parë ata kërkonin "që kjo histori e ndyrë të merrte fund njëherë e mirë, duke kërkuar rikonstrukcionin e TK-së, pa harruar të kërkojnë të vihen para përgjegjësisë ligjore ata që shkakjuan këto probleme". Askush nuk ka shkuar para përgjegjësisë.

Ka një jetër të datës 20 korrik 2002 kur këshilli i artistit i Teatrit Kombëtar i ankohet për Edi Ramën (atëkohë në krye të bashkisë) presidentit Alfred Moisiu, kryetarit të Kuvendit Servet Pellumbi, kryeministrit Fatos Nano, ministres së Kulturës Arta Dade dhe Prokurorit të Përgjithshëm, Theodorri Sollaku.

Ndërsa këtë të hënë, në betejën e dytë të artistëve në mbrojtjen e teatrit, 20 vite më vonë, bëhet takimi i 4 publik, Kastrioti Çipi, ka sjellë në vëmendje se çfarë ndodhte me përplasjen Rama-artistë 16 vite më parë. Kanë ndryshuar pozicionet e palëve, por jo qëndrimet e tyre ndaj godinës, ndaj e ndonëse e "ndarë" në kohë, lufta është e njëjta.

Takimi i ditës së hënë ka për qëllim informimin e publikut mbi ligjëshmëritë dhe paligjëshmëritë e ndërhyrjes në Teatrin Kombëtar. Ky takim gjithashtu të traj-

*Artistët mbledhen sërish të hënë në teatër kundër vendimit të qeverisë*

*Kronologjia e një shembjeje të paralajmëruar dhe skenari i përsëritur 16 vite më vonë*



tojnë edhe rolin e qytetarit si dhe instrumentet që ai ka në dispozicion për të dhënë kontributin e tij në këtë vendimarrje. Në këtë takim do të jenë të ftuar ekspertë të fushës së jurisprudence, të cilët do mbajnë disa fjalime informative mbi këto tema. 16 vite më pas, disa nga ata që kanë firmosur letërën e mëposhtme nuk jetojnë më. Disa kanë ndryshuar qëndrimin e disa heshtin, ndonëse janë kontaktuar nga media.

### SHKRESA E VITIT 2002

Që në nisje, letra është e ashpër: "në emër të artistëve, ju shprehim shqetësimin tonë të thellë për abuzimin me të fundit me pushtet të kreut të bashkisë, Edi Rama: shpalljen e konkursit për projekt për ndërtimin e Teatrit Kombëtar. Letra që mban firmën e Agim Qirjaqi, Robert Ndrenkës, Ruzhdi Pulahës, Shabanë Hysës, Roland Tre-

bickës, Ahmet Pashës, Rajmonda Bulku dhe Kiço Londo, kujton se muaj më parë ishte bërë debat i gjerë për ruajtjen e godinës historike të Teatrit Kombëtar. "Ju jeni në dijeni të propozimit diskret të ish-drejtorit Ferri, për shembjen e godinës aktuale dhe zëvendësimin e saj me një 'kompleks social biznesi' në të cilin Teatri Kombëtar do të kishin vetëm 20% të vëllimit të ndërtimit. Ju jeni në dijeni

të reaksionit që, një projekt i tillë i tipit mafioz, ngjalli në komunitetin e artistëve", shkruanin artistët duke këmbëngulur që duan ta ruajnë, për çka sipas tyre janë mbështetur nga 65 deputetë. Në vijim, kryeministri Majko shkarkoi drejtorin e TK-së dhe qeveria u deklarua publikisht në favor të ruajtjes së godinës, ndërsa ministria e linjës organizoi tenderin për rikonstrukcion, në vlerën 22.5 milionë lekë. Artistët vërejnë se këto qëndrime të politikës e zbutën klimën e komunitetit të artistëve të teatrit dhe i hapën rrugën bashkëpunimit shtet-artistë, gjë që sipas tyre "kishte munguar prej katër vitesh kur në krye të Ministrisë së Kulturës erdhi E.Rama".

Por - thonë ata - nuk ishte e thënë të mbaronte me kaq. As peticionet e artistëve, as promemoria e deputetëve, as qëndrimi publik i qeverisë, madje as organizimi i tenderit nga Ministria e Kulturës nuk e bindën E.Ramën të harronte një herë e mirë ëndërrën e tij të jetëvjetër për shembjen e Teatrit Kombëtar. I inkurajuar prej dorëheqjes së kryeministrit Majko, kryetarit i Bashkisë së Tiranës ka shpallur dhe ka bërë publike thirrjen e tij për projekte ndërtimi për Teatrin Kombëtar, mbi truallin e teatrit ekzistues, megjithëse ky i fundit, me ligj është institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës".

tiko-mafioze, interesat korruptive të së cilës nuk lidhen me reformat administrative, as me nevojën për zhvillim kulturor, por vetëm me truallin e çmuar në qendër të Tiranës.

Pasi renditet e gjithë përplasja e Ramës me artistët, çka çoi deri në mbylljen e Teatrit Kombëtar për herë të parë në historinë e tij.

Shënojnë faktin që ish-drejtori Sulejman Dibra mori urdhrin e shkarkimit të menjëhershëm, sapa i dërgoi Ramës projektin e i konstruksionit të TK-së.


Shënojnë dhënie me qira të hollë të TK-së, që u pagëzua si "teatri i parë privat" me emrin "Rubairat", por që funksionoi si klub nata me emrin "Bretkosa".

Teksa sjellin kronologjinë e zhvillimeve, artistët vërejnë se në shtator 1999, ish-ministri Rama bëri që të dëshontonte projektin i qeverisë italiane, që parashikonte restaurimin e ndërtimeve të kryera nga Italia para luftës, me një fond prej 3 miliardë liretash. Në kundërshtim me kriteret e projektit, Rama nuk e propozoi ri konstruksionin e Teatrit Kombëtar, por ndërtimin e një sale të re me 230 vende. Më pas edhe fondi grek u caktua për një turrall tjetër.

Në janar 2000, në kundërshtim me vullnetin e artistëve që kishin muaj që protestonin në rrugë, duke provuar deri edhe grevën e urisë, në Kuvend u paraqit një projektligj për Teatrin, i sponsorizuar nga Rama, që parashikonte shkëputjen e artistëve të teatrit nga godinat e teatrove.

Në fund, artistët shënojnë se kanë katër vite që luftojnë me mafien e ndërtimit. "Vetëm tani kur bëhet publik projekti i bashkisë për ndërtimin e teatrit të ri në truallin e atij ekzistues, bëhet e qartë si drita e diellit se gjithçka që ka ndodhur, makinaqionet e manovrat, premtimet e shprehura, presionet e bllokimet, është pjesë e një skenari kriminal, frymëzuar e sponsorizuar nga një aleancë e ndyrë mafiozësh të biznesit dhe politikës, me qëllim shembjen e TK dhe lirim të truallit".

thonë artistët Qirjaqi, Ndrenka, Pulaha, Hysa, Pasha, Bulku e Londo.




Faksimile e shkresës së vitit 2002, ku artistët i ankohen presidentit Alfred Moisiu, kryetarit të Kuvendit Servet Pellumbi, kryeministrit Fatos Nano, ministres së Kulturës Arta Dade dhe Prokurorit të përgjithshëm, Theodorri Sollaku.

Artishtë theksojnë se Teatri Kombëtar duke filluar nga korriku i vitit 1998, po mbahet peng nga qarqe poli-

E DIEL  
1 Prill  
2018



G.J.K. Skënderbeu, Ilustrimi nga koleksioni Ambraser në albumin e ekspozitës në Hildesheim



NGA BAJRAM PEÇI

**K**a qenë koleksionisti i veprave të artit, një personalitet i shquar i Rilindjes italiane, Paolo Giova (1483 –1552), i cili, falë pasionit të tij, besohet se ka bërë të mundur të mbërrijë deri në ditët tona pamja e heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Peshkop, mjek, fizikant, historian dhe biograf, ka hyrë në të famshmit si krijuesi i muzeut "Uomini illustri", me koleksionin më unik që ishte parë me vepra arti në Europën Mesjetare.

Monedhat dhe medaljet, si pjesë e arteve dekorative, nga koha e Fulvio-s dhe Giova-s u shndërruan në disiplinë ndihmëse të historisë

Ideja e Giova-s për themelimin e një muzeu me portrete të njerëzve të shquar, perandorë e papë, filozofë, figura të letrave e sundimtarë, luftëtarë të famshëm, artistë dhe gjeneralë, ka qenë ndoshta mendimi më origjinal i qytetërimit evropian të kohës. Pasioni për koleksionim të portreteve nisi në periudhën e Rilindjes. Pak para tij, ishte orvatur të vinte gurët e parë në themelet e një ngrehine kulturore, që do bëhej më pas shtëpia e artit dhe qytetërimit, bashkëkohësi Andrea Fulvio, (1470-1527). Ai ishte një humanist, poet dhe antikuarist italian i Rilindjes, koleksionisti që u orvat i pari të bëjë identifikimin e fytyrave të famshme të Antikititit me burim monedhat dhe, po kështu, i pari antikuarist që bëri regjistrimet epigrafike të rrënojave të lashta të Romës. Pamjet e ilustruara prej tij i botoi në dy vëllime. Njëri përmbante pamjet e fytyrave të famshme të Antikititit nga provat numizmatike dhe tjetri ishte një udhëzues për antikitetet e Romës. Librin e parë të burave të shquar të bazuara në burime të numizmatikës e ka kryer në bashkëpunim me antikuaristin tjetër, Jakopo Mazzocchi. "Njerëzit e famshëm" të botimit të ilustruar ishin perandorë romakë dhe romakë-gjermanikë. Të tjerë, që fillonin me Aleksandrin e Madh të Maqedonisë, përfshih-

nin perandorët bizantinë, princat Karolingian, etj.

Risia që ai solli në artin e bërjes së portreteve ishte ideja dhe

përpjekja për të bashkëpunuar me piktorët, që për identifikimin e fytyrave të njerëzve të famshëm të Antikititit, tashmë të harruara,

të përdorëshin monedhat dhe medaljet perandorake. Ngjashmëritë në monedhat e medaljet prodhuan artin e portreteve. Ful-

vio vlerësohet si themeluesi i artit të numizmatikës dhe epigrafisë.

→ **Vijon në faqen 14**

# Koleksionistët dhe artistët që ruajtën imazhin e Skënderbeut

**Në këtë numër: PROF. GJERGJ SINANI, BAJRAM PEÇI, GAZMEND KRASNIQI, HALIL RAMA, ZYHDI DERVISHI, KUJTIM DASHI ETJ...**

I

## ARGUMENT

*Ka qenë koleksionisti i veprave të artit, një personalitet i shquar i Rilindjes italiane, Paolo Giovio (1483–1552), i cili, falë pasionit të tij, besohet se ka bërë të mundur të mbërrijë deri në ditët tona pamja e heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Peshkop, mjek, fizikant, historian dhe biograf, ka hyrë në të famëshmit si krijuesi i muzeut "Uomini illustri", me koleksionin më unik që ishte parë me vepra arti në Europën Mesjetare.*



Medalje e Skënderbeut në albumin e P. Voltolina, Romë, nr. 66



Medalje e Skënderbeut në albumin e P. Voltolina, Romë nr. 67



Medalje e Skënderbeut, ilustrim në botimin e Padiglione "Skënderbeu dhe pasardhësit e tij"

# Koleksionistët e portreteve, medaljet dhe portretet e Skënderbeut

NGA BAJRAM PEÇI

Vijon nga faqja 1

I denë e Fulvios e ndoqi Giova. Qëllimi ishte të ringjallëshin me vetëdije e të nxirreshin nga muzgu i shekujve të shkuar, duke besuar se pamjet në portrete e njerëzve që kishin shkëlqyer në lavdi dhe mençuri, nëse vendosen para syve, do të ndihmonte në fisnikërimin dhe nxitjen e shpirtit. Shembuj të koleksioneve të artit të imazhit ndesheshin në buste bronzi të filozofëve në bibliotekat romake, por asnjë nga këto nuk ishte konceptuar me qëllimin e shprehur të ndërtimit për publikun, siç Giovio e shprehu në projektin e tij. Të dy, të paruarur nga njëri-tjetri, përpos ilustrimit të imazhit, bënë për to dhe nga një përshkrim të shkurtër historik.

## KRIJIMI I NJË MUZEU TË PASHEMBULLT NË LLOJIN E TIJ

Rilindja shënoi një përmbyse cilësore në historinë e portretizimit. Kthesa e marrë zëvendësoi ikonografinë që mbështetej mbi librat e shenjtë kristianë me interesin për botën natyrore, për njeriun "tokësor", për kulturat klasike të Romës e Greqisë së lashtë. Portretet, të pikturuara e të skalitura nga gjenialiteti artistik që polli epoka, ende nuk janë kapërcyer.

Giovio e filloi mbledhjen e portreteve rreth vitit 1512, pasi ishte larguar nga Komo, qyteti i tij i lindjes, për të ndjekur karrierën e prelatit kristian në Romë. Prej portreteve të njerëzve të shquar të letrave, si Virgjili, Dante Aligheri e Petrarka, koleksioni filloi të përfshijë figurat ushtarake, mbretërit, papët dhe artistët e shquar të epokave të kaluara. Ai dëshironte jo idealizime, por portrete të nxjerrë nga jeta, sa herë të ishte e mundur. Në mungesë të të tilla mundësive, u jepte porositi pikturorëve të mbështeteshin të ngjashmëritë e prodhuara në monedhat, bustet ose medaljet perandorake e mbretërore që ekzistojnë. Kronistët shënojnë se për mbledhjen e koleksionit atij ju desh t'u shkruante dhjetëra figurave publike në Europë dhe në Lindjen e Afërt, për

t'u kërkuar portrete. Ishte fillimi i koleksionimit të monedhave dhe ish-in monedhat e lashta, që bënë përmes portreteve të pavdekshëm shumicën e më të shquarve, që bota klasike kish nxjerrë me madhësinë e saj, në kapërcimin e pragut të qytetërimit modern. Nevoja për të zgjuar kujtimet e të shkuarës, përpos artit të krijimit të portreteve, lindi shkencën e numizmatikës me tërë peshën e vlerat që mban studimi historik, ekonomik e kulturor i tyre.

Ndërtimin e muzeut Giova e nisi në vitin 1537 dhe e përfundoi në vitin 1543. Pikturat e portreteve të ndara në katër kategori subjektsh, u organizuan brenda grupeve në mënyrë kronologjike, sipas datës së vdekjes ose nga viti i lindjes, nëse personi ishte ende gjallë. Giovio i shoqëroi portretet me biografi të shkurtër të cilat janë botuar dhe njihen shkurtimisht si "Elogia". Paolo Giova pasoi kështu përvojën e antikuaristit Andrea Fulvio, që në vitin 1517, portretet e marra si pamje nga monedhat i kish shqëruar me shënime. Ishte gjithashtu një grup i ilustruar i rreth 700 figurave të famshme të botës së lashtë, të bëra prej Fulvios, që mund të kenë frymëzuar Giovio-n. Ndërsa Fulvio portretet i botoi në katalog, Giova i porositi që të punoheshin artistikisht me teknikën vaj në dru.

## BELINI DHE PORTRETI I TIJ PËR NJË SULLTAN

Nga koleksioni i këtij kolosi të Rilindjes dhe veprës së tij në Komo, janë të shumtë muzeumet që sot përhapin kulturën e nxinis turizmin, duke patur në zotërim pjesë të fondit të tij. Paolo Giovio mblodhi e kopjoi nga mjeshtra të mëdhenj të epokës shumë vepra të njohura, mes të cilave edhe heroin tonë, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Vlen të përmendim në funksion të qëllimit për portretin e Skënderbeut, edhe një portret të Sulltan Mehmetit II, i krijuar si kopje nga modeli origjinal i Belinit. Është e njohur se kopja është bërë nga piktori Kristofano dell'altissimo. Kronikat shënojnë se Sulltan Mehmeti II, në mënyrë të pazakontë për ritet myslimane, na paska dërguar një misionar



Medalje e Skënderbeut, modeluar nga skulptori austriak, H.Kautsch

## Sulltan Mehmeti II dhe Belini

Kronikat shënojnë se Sulltan Mehmeti II, në mënyrë të pazakontë për ritet myslimane, na paska dërguar një misionar diplomatik në Venedik, me detyrën për të gjetur një piktor me emër dhe për ta sjellë në Stamboll. Ishte artisti Gentile Belini, që u zgjodh të shkonte në Portën e Lartë në vitet 1479 dhe 1480 e të realizonte portretin. Historianët dhe kritikët e artit përmendin se në fondin e tij figurorin edhe disa ai skica e piktura shqiptarësh. Ska dëshmi e prova se ku mund t'i ketë bërë. Mund t'i ketë kryer edhe duke kaluar transit, gjë që u dha mundësi hamendësimeve se ka modeluar Skënderbeun në një portret, pa qenë nevoja ta bënte këtë në Venedik!

diplomatik në Venedik, me detyrën për të gjetur një piktor me emër dhe për ta sjellë në Stamboll. Ishte

don, shkruan se kuratorët e kanë etiketuar pikturën si "Atribuuar" dhe jo piktuar. Siç nuk dihet plotësisht fati i këtij portreti, me largimin nga jeta e themeluesit të muzeut, nuk dihet dhe fati i një shumice të tjerë portretesh, pasi arkivin-muzeum të 484 portreteve e preknë, e shpërbënë. Ai humbi, për të ngulur në kopje.

## KOPJET NË PIKTURË TË PORTRETEVE TË SKËNDERBEUT

Portrete të Skënderbeut e kanë prejardhjen nga galeritë e pikturave, që u kopjuan në Itali prej shtëpive mbretërore të Europës Veriore në fillim të shekullit të 16-të. Pas vdekjes së Paolo Giovios në vitin 1552, koleksioni origjinal u shpërnda dhe humbi. Disa portrete mbahen në Pinakoteka "Civica di Palazzo Volpi", në Komo. Shumica ruhet në Uffizi si kopje të piktorit Kristofano dell' Altissimo, i cili kaloi 37 vjet duke kopjuar portretet nga viti 1552 deri më 1589. Njihën vetëm tre koleksione pikturash me portrete të «Burra të famshëm» të cilat përmbajnë portrete të Skënderbeut dhe janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Këto janë koleksionet e peshkopit të Nocera, Paolo Giovio; të Dukës Kosimo i Parë të Firences dhe ai i Arqidukës Ferdinand von Tirol të kështjellës Ambras. Midis portreteve të koleksioneve të mësipërme egzistojnë ngjashmëri të mëdha ikonografike, sepse këto portrete u krijuan si kopje të origjinalit. Duka Kozimo i Parë de' Medici i kërkoi Kristofano Altissimo t'i kopjonte koleksionin e Paolo Giovios rreth viteve 1552 dhe 1564. Të njëjtën gjë bëri edhe Arqiduka Ferdinand. Një artist i pikturës (emri i të cilit nuk është i njohur) u dërgua prej tij në Firencë, me qëllim që të kopjonte fondin e portreteve të kryeqytetit të artit. Një sërë kopjesh të bëra për Kozimo i Parë de' Medici tani janë strehuar përherëshmërisht në Galerinë Uffizi të Firences.

Arqiduka Ferdinand kërkoi të kopjoheshin dy portrete të Skënderbeut. Njerin prej tyre, që ilustron artikullin, e kam nxjerrë nga botimi "ALBANIEN Schätze aus dem Land der Skipetaren". Grup-redaktorët e këtij botimi luksoz 480 faqesh të botuesit "Verlag















Opinion **i** Ditës

# Një shikim përtej tunelit të Kalimashit

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

...është se ndjeshmëria tek njerëzit është e lartë. Hyjnë edhe ata që janë të rreshtuar qartazi me të majtën. Për herë të parë hyra në profilin e kryeministrit, që komentonte ngjarjen e tunelit të Kalimashit dhe e vërtetova se shumë të njohur të mi, jugorë e veriorë, të cilët në rreshtimin e tyre janë të majtë, e kundërshtojnë. Ndoshta kjo është pika e ujit që mbush gotën e zemërimit, por tashmë Rama ka ardhur koha që t'i bëjë pyetjen vetes se kë përfaqëson.

Në pesë vjet të qeverisjes së tij, ai ka zgjedhur qartazi krahun e të pasurve. A vjen kjo për arsye përtese të drejtimit të shtetit; a vjen sepse nuk ka ide dhe ia lë privatit barrën; apo për arsye korruptive, ky tashmë nuk është një problem i njerëzve, por i tij. Por ka ardhur koha që ai të vendosë se çfarë të hedhë në tregun e ekonomisë. Nuk mund të vazhdojë më me një ekonomi, e cila mbahet vetëm nga taksat, të cilat pastaj shpërndahen nëpër klientelën e tij, duke krijuar pozita oligopoli që po u marrin frymën njerëzve.

Ana tjetër e medaljes është ekonomike. Po sot, edhe për fundjavë pas kaq muajsh në bregdetin e Golemit, hotel "Fafa" ku ndenja për drekë ishte plot me kosovarë që kalojnë fundjavën. Hotel "Flower" po në këtë zonë duhej prenotuar ditë përpara se ishte gjithashtu i mbushur me kosovarë. Por ndërkohë pas protestës, klientët nga Kosova kanë anuluar prenotimet për javët e ardhshme. Tani shtrohet problemi, a u ka hyrë njeri llogarive kur merr këtë taksë nëse vendit i interesojnë 5 euro në grykën e tunelit që punësojnë 100 vetë, apo qindra e mijëra euro që harxhojnë edhe jashtë sezonit në bregdetin tonë, mijëra kosovarë të cilët punësojnë mijëra vetë, ku këta mijëra vetë krijojnë eksperiencë që në verë të presin polakët dhe suedezët? Mesa duket, duhet të mbledhim mendjen që t'i bëjmë rrugët pa pagesë direkte për vendësit dhe me një taksë vjetore për të huajt, pavarësisht nëse futen një herë apo 100.

Ndërkohë, nuk mund të lihet pa cituar problemi i rrugëve. Pesë



vjet pasi ka ardhur në pushtet e majta, ende nuk janë mbyllur rrugët që la të hapura Berisha. 'By Pass' i Fierit dhe Vlorës janë paguar nga dy herë dhe nuk po përfundojnë, rruga Tiranë-Elbasan po ashtu, duhet të përfun-

dojë urgjent segmenti Tiranë-Milot ku makinat ecin me shpejtësinë e hapit të njeriut, si dhe të zgjerohen segmente të tjerë si ai Elbasan-Pogradec, që është atrofizuar komplet.

Ky vend të vetmen të ardhme që

ka është turizmi, ndaj shtrohet urgjente modernizimi i rrjetit rrugor, i cili nuk mund të bëhet duke e pasur mendjen të nxjerrësh dhjamë nga pleshti, por me biznesplane të qarta dhe afatgjata.

"dritare.net"



## HOROSKOPI

### DASHI

Plutoni jo shumë miqësor do t'ju kujtojë se duhet të ndërtoni marrëdhënie të karakterizuara nga ekuilibri i duhur midis rastësisë dhe vetëkontrollit. Vazhdoni të hani në mënyrë të shëndetshme, duke zgjedhur me saktësi ushqime të cilësisë së mirë.

### DEMI

Hëna rrit optimizimin dhe aftësinë komunikuese. Vërtet do të jeni pak egocentrikë, por edhe të shkëlqyer dhe interesant si kurrë më parë! E dini fatin tuaj, por do të arrini edhe të përfitonin nga rasti për të mësur nga persona vërtet të veçantë.

### BJNJAKET

Mirëkuptimi i personave që ju qëndrojnë në krah do ta ketë të vështirë të qetësojë nervozizimin e juaj. Do të jetë e vështirë të ruash qetësinë ndaj atyre që vazhdojnë të bëjnë po të njëjta propozime shumë e shumë herë.

### GAFORJA

Me planeten e dashurisë që ju mbron, do të kërkonti mundësi dialogu dhe bashkëpunimi me personin e zemrës. Lidhja do të rezultojë më e forcur. Me Venusin që vazhdon t'ju mbrojt, nuk duhet të shtroheni shumë për të qëndruar në formë.

### LUANI

Do të keni fërkime me një familjar që këmbëngul që gjithçka shkon mirë, ndërsa në realitet ka tensione të fshehura. Kush jeton në çift duhet të bëjë kujdes që të mos ndërlikojë atë që është e thjeshtë dhe e drejtë-përdrejtë.

### VIRGJERESHA

Me favorizimin e Jupiterit, nëse jeni në kërkim të një pune, dijeni se fati mund t'ju trokasë në derë. Mos rrini duarkryq. Me Venusin mik që ju vëzhgon, mund të hapni një kapitull të ri në lidhjet tuaja dashurore.

### PESHORJA

Ndonjë zënkë më shumë dhe klima dashurore do të ndikohet ndjeshëm. Do të jetë më mirë t'i kontrolloni reagimet tuaja të gjaknxehtësisë. Një mik, vetëm për të mohuar mbështetjen e premtuar, do të përpjetë t'ju fusë dyshime për zgjedhjen e bërë.

### AKREPI

Venusi, Marsi dhe Neptuni bashkëveprojnë me Hënë në favorin e juaj. Do të njihni persona, të cilët mund t'ua vërtetojnë menjëherë vlerën dhe sinqeritetin. Po kaloni një periudhë ndryshimesh në çdo fushë. Të papriturat do t'ju bëjnë përsëri vizitë.

### SHIGJETARI

Do të kaloni disa zënka dhe do t'ia dilni të tejkaloni të gjitha pengesat që ju ndalojnë të merrni vesh me partnerin e dashur. Mos i lini pas dore çështjet private për të dëgjuar dhe për të ndihmuar një person që ju kërkon ndihmë.

### BRICJAPI

Me Neptunin që ju mbron, mund të mbështeteni tek miqësi dhe kontakte konstruktive. Jini të sigurt, jeta e juaj është duke evoluar në drejtime më interesante. Me Marsin armiqësor, kini kujdes nga gabimet në vlerësimin e sjelljeve për të mos gabuar.

### UJORI


Do t'ju duhet të përballeni me ndonjë të papritur dhe nuk do të keni atë elasticitet që do të ishte i nevojshëm për t'u përballur me risi dhe për të riorganizuar programin. Kjo mënyrë e vazhdueshme për të pyetur të tjerët ndoshta fshih paafësinë për pranuar atë çka është e ndryshme nga ju.

### PESHQIT

Në ndikimin e Uranit dhe Venusit priten, mbi të gjitha nëse jeni beqarë, perspektiva interesante rrisht në sektorin e dashurisë. Do të rrethoheni nga njerëz me të cilët ndihen mirë dhe do të mënjanojnë ata që duan t'ju detyrojnë zgjedhjet edhe mendimet e tyre.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- Ilashtë.
- Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhën për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotualet.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkodran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.

- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë.
- Ishin monedhe të Tobias.
- Eshhtë bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Eshhtë marrëveshje me nota.
- Ishite babai i Aklilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Eshhtë faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Eshhtë shtet aziatik.
- Eduard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.

- Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Eshhtë e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë.
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Ishite nyja që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

**VERTIKAL**

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Eshhtë metri i rrobaqepësti.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Des-cartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministrë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Eshhtë ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.

- Ente Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditë.
- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Eshhtë kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Eshhtë tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.


**VERTIKAL**

- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Eshhtë edhe ajo e historisë.




- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicialet e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Eshhtë trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktor.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

	3		4		1		6	
		4	8		9	1		
2				5				9
1	2						8	3
		8				6		
5	6						7	4
7			4					1
		6	2		5	4		
	1	3		8			9	

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	6	5	3	4	1	2	9	8
3	4	2	7	8	9	6	1	5
8	9	1	6	2	5	3	7	4
5	3	4	1	9	6	8	2	7
6	8	7	4	5	2	9	3	1
2	1	9	8	3	7	4	5	6
4	2	6	5	1	3	7	8	9
1	7	3	9	6	8	5	4	2
9	5	8	2	7	4	1	6	3


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Të jesh me karakter do të thotë të jesh i drejtë edhe kur s'të sheh njeri.
- Kurrë s'e bëj gabimin e të debatuarit me njerëz, për opinionet e të cilëve nuk kam respekt. (Edward Gibbon)
- Nuk është e bukur ajo që është e bukur, por e bukur është ajo që ju pëlqen. Italiane
- Fillimi i mirë - garanci e mbarimit të mirë. Fishart

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm



- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë kur sulmohen në pikat e dobëta.
- Asgjë nuk është më e shtrenjtë, se sa ajo që blihet me lutje..!
- Nëse asnjë s'të ka zili, dije se ti je njeri i dështuar. Pema me kokrra synohet, tjetra harrohet...
- Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë. (Albert Anjshajn)
- Eshhtë më mirë t'i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni. (Mark Tueni)

*Ehënie të mençura*

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

M A T A H E L M E T  
A R R V E D D E P P  
P A R A L E L E T L E R  
P O L I F E M I O L E  
E M I L E Z O L A E T I K  
L A I R A E R R E Z E  
E R A I B E M R I I S  
H I M A E S T R O D E  
T A L E N T E T A R E  
E K R A H O R A R T A  
K A P A N O N E T L A L A

**FJALËKRYQI (2)**

D I S K O T E K A T A P  
R O M A N A R G O S A  
E N T G N I R H R  
W M O N O G R A F I A A  
P E L E G R I N A Z H E T  
P O L I G L O T E T I D E  
A L K R A H E T K A T E T  
K E N I T T K A T E T  
E M I L E E N J O M E R  
T I M E R S T A N E T I  
A K S E R I O Z K R A M  
T E O T R A Z J A R R I

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!

